



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 10 MARS 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 10. MARTA 2016. GODINE**

**MARS - MART
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për falimentimin,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mjekësinë ligjore,
14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
15. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin,
16. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
17. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie,
18. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Formiranje Nezavisnog izbornog organa za izbor članova Organa za razmatranje javnih nabavki,
5. Prvo razmatranje N/zakona o prirodnom gasu,
6. Prvo razmatranje N/zakona o regulatoru energije,
7. Prvo razmatranje N/zakona o električnoj energiji,
8. Prvo razmatranje N/zakona o energiji,
9. Prvo razmatranje N/zakona o trgovini naftnim derivatima i obnovljivim goriva na Kosovu,
10. Prvo razmatranje N/zakona o stečaju,
11. Prvo razmatranje N/zakona o pravilima u drumskom saobraćaju,
12. Drugo razmatranje N/zakona o sigurnosti na radu o mineralnoj delatnosti
13. Drugo razmatranje N/zakona o sudskoj medicini,
14. Razmatranje preporuke Komisije za evropske integracije o Narodnom programu za sprovođenje Sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju.
15. Razmatranje izveštaja Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona o standardizaciji,
16. Predlog za formiranje Ad-hoc komisije za izbor članova Borda RTK-a,
17. Predlog za formiranje Ad-hoc komisije za izbor članova Nezavisne komisije za medije,
18. Predlog PG PDK-a o imenovanju članova u parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Deputetë të nderuar,

Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, e me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i ish-deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, i cili ka dhënë dorëheqje, me kandidatin e subjektit politik të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ali Berisha.

Deputetin e ri e njoftoj se betimi është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Tekstin e deklaratës së betimit deputeti e ka para vetes dhe e njëjta duhet të nënshkruhet personalisht.

Për ta përmbushur këtë detyrim, lus deputetin që të ngrihet në këmbë, ta dëgjojë tekstin që do ta lexoj unë dhe më në fund e shqipton fjalën “Betohem!”.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!”

(Duartrokitje)

Faleminderit! Deputetit të ri i dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë. Mirë se ke ardhur në Kuvend! Faleminderit!

Jemi në pikën e parë e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime është 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Zonja Alma Lama dhe Nuredin Ibishi nga grupet parlamentare. Zonjës Alma Lama e para, po i japim përparësi se e kemi pasur afër 8 Marsin. Urdhëroni, zonja Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Situata problematike në Kuvend ka bërë që të harrojmë ose t'i lëmë pasdore disa çështje të tjera. Arsyeja se pse sot po e marr fjalën lidhet pikërisht me 8 Marsin - Ditën Ndërkombëtare të Gruas, që u përmend para dy ditësh.

Personalitete të larta shtetërore bënë homazhe te memoriali "Heroinat" në shenjë respekti për kontributin e gruas. Një veprim jashtëzakonisht i mirë dhe në përputhje me qëllim e vetë ndërtimit të këtij memoriali, ndërtimi i të cilit është mbështetur nga Kuvendi i Kosovës.

Unë sërish po e marr fjalën në Kuvend për të kërkuar ndihmë, në fakt për t'i bërë thirrje Komunës së Prishtinës që ta rregulloj ambientin përreth memorialit, ta bëjë një lulishte dinjitoze, sepse për momentin është i rrethuar me baltë dhe gurë dhe nuk dua të them që kjo situatë përreth memorialit është e ngjashme me respektin që ka Komuna për kontributin e grave, por mendoj që është çështje neglizhence nga ata. Prandaj, po shpresoj dhe po i bëj thirrje kryetarit, zotit Shpend Ahmeti, që ta marrë seriozisht këtë punë. I vetmi memorial që i kushtohet kontributit të grave në Kosovë meriton përreth një ambient shumë më dinjitoz. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Lama! Zoti Ibishi e ka fjalën.

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

Prapë! Lëshoni ventilatorët, ju lutem! Ventilatorët, ju lutem! Bëjmë pauzë 10 minuta, se largohet, dhe e vazhdojmë menjëherë seancën, ju lutem!

* * *

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë,

Ju lus që t'i zini vendet tuaja. Unë mendoj që sigurimi nuk ka nevojë të qëndrojë te foltorja, s'kemi aso situatë aktualisht. Ju kisha lutur që të zhvendoset sigurimi nga foltorja. Mendoj që s'kemi ndonjë situatë që ka nevojë më... Faleminderit!

Jemi në pikën e parë, do të thotë Deklarime jashtë rendit të ditës.

Sipas radhës së paraqitur ka diskutuar një diskutues, radhën e ka zonja Labinotë Demi.

LABINOTË DEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni në fillim të fjalës sime të uroj dy ministrat të Qeverisë sonë për anëtarësimin e tyre në Akademinë Evropian të Shkencave dhe të Arteve, akademik Arsim Bajrami dhe profesor doktor Ferid Aganin.

(Duartrokitje)

Ky është nder për popullin tonë, për vendin tonë, për Qeverinë, por edhe për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërkohë, meqë tani e kemi edhe kryeministrin të pranishëm, pasi jemi në këtë 10-ditëshin e parë të muajit mars, kur edhe kemi pasur data të shënuara për gruan dhe mësimdhënësit dhe meqë po presim riformimin ose riformatimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ne shpresojmë që të kemi edhe prani më të madhe të grave të merituar në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

KRYESUESI: Faleminderit! Lëshojeni ventilatorin! Pauzë, 10 minuta!

LABINOTË DEMI: Meqë edhe e kam fjalën, unë shpreh shqetësimin tim për gjithë çfarë po ndodh. Kam tërhequr vërejtjen edhe në seancën e kaluar, edhe në këto kushte të jashtëzakonshme, do të them se prapë pavarësisht protestave, pavarësisht pakënaqësive të përgjithshme, të mos harrojmë se ky Kuvend ka edhe gra në gjendje të jashtëzakonshme - kolege tona, të cilat presin të bëhen nëna.

Ndërkaq fjala ime kishte të bënte pikërisht me një rast të tillë të dëmtuar gjatë procesit të lindjes. Kërkoj mirëkuptimin e tyre, sidomos personelit, njerëzve me profesion në fushën e shëndetësisë, e bëjnë akte të tilla, kjo me të vërtetë e papranueshme për gjithsecilin prej nesh.

KRYESUESI: Zoti Ibishi e ka fjalën!

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Shqetësimi që dua ta ngre dhe shkurtimisht ta përshkruaj gjendjen është niveli i ulët i sigurisë së komunikacionit rrugor në Kosovë, sidomos aksidenteve me fatalitet, ku për pasojë ka humbje jete në njerëz, dëmtime të mëdha në shëndet dhe trup dhe dëme materiale.

Ende askush nuk e ka trajtuar gjendjen për personat që mbeten invalidë dhe janë barrë e familjes dhe shoqërisë.

Gjendja e sigurisë së komunikacionit rrugor në Republikën e Kosovës në vazhdimësi karakterizohet me numër të madh të aksidenteve që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm, që për pasojë kanë një numër relativisht të madh të viktimave dhe dëmeve, të cilat do të mund të evitoheshin ose të paktën të kontrollohen me qasje dhe politika proaktive me zbatimin strikt të ligjeve dhe rregullave të sigurisë së komunikacionit rrugor, siç janë praktikatat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë, në vitin 2011 Kosova kishte një milion e 739 mijë e 825 banorë, ka 262 e 026 automjete të regjistruar. Këto janë të dhënat e dhjetorit 2015, pa i llogaritur automjetet e KFOR-it, të EULEX-it, të organizatave tjera ndërkombëtare, automjetet me regjistrim të huaj. Ka mbi 8 000 kilometra rrugë, autostradë, rrugë magjistrale, rajonale, rrugë lokale, por krahasuar me gjendjen e tyre është larg nivelit të Bashkimit Evropian.

Kur i krahasojmë statistikën e aksidenteve me fatalitet vetëm në dy vjetët e fundit, në Kosovë shohim se ka rritje të tyre për gjashtë raste, ose 5,41% nga 111 raste, sa ishin në vitin 2014, me 117 raste në vitin 2015 dhe numri i të vdekurve për dy rastet 1,57%, nga 127 në vitin 2014 në 129 viktima të vitit 2015. Vetëm në vitin 2015 kemi pasur 10 mijë e 671 persona të lënduar, nga të cilët një masë e madhe me pasoja të përhershme invaliditeti dhe shumë dëme të mëdha materiale.

Nga këto viktima të komunikacionit rrugor në vitin 2014 kanë pësuar 39 këmbësorë dhe në vitin 2015 gjithsej 44.

Në pesë vjetët e fundit 2011-2015, persona të vdekur nga aksidentet në trafik janë 653. Këto të dhëna tregojnë një trend në rritje dhe nga mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për Policinë e Kosovës nga Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Sigurisë lidhur me sigurinë në trafik del me këtë rekomandim, i cili miratohet nga ky Kuvend, ku përcaktohet që duhet të ndërmerren masat e nevojshme ligjore dhe administrative, konfiskimi i përkohshëm i dokumenteve personale si garanci për realizimin e dënimeve mandatore të shqiptuara nga Policia dhe gjykatat për ta përmirësuar situatën e rëndë të sigurisë në komunikacionin rrugor me trend të lartë të aksidenteve në trafik me pasoja të fatalitetit të vdekjes dhe dëmeve të mëdha materiale.

Ky rekomandim vjen nga shkak se nga 3 971...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja fjalën!

NUREDIN IBISHI: Pra, nga 3 971 tiketa të shqiptuar nga Policia e Kosovës ose të dërguar në procedurë gjyqësore janë realizuar pak më shumë se 10%. Dhe, kur nuk ka ndëshkim për shkelje të rregullave të trafikut për pjesëmarrësit në komunikacion, natyrshëm edhe vjen te rritja e saj, që si pasojë ka aksidentet e shumta dhe të ato me fatalitet.

Propozoj që Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me ART-në dhe Policinë e Kosovës të plotësojë dhe ndryshojë udhëzimin administrativ që t'i shtojë kriteret nëse ka një pronar i makinës tiketë dënimi të pa paguar, në mënyrë që të bëhet inkasimi i tiketave të shqiptuara në 100%.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, institucionet përkatëse në nivel kombëtar, si dhe ekspertët e komunikacionit rrugor publikojnë të dhëna se në krahasim me Evropën, vendet e rajonit, ku bën pjesë edhe Kosova, vdekjet në aksidente dhe pasojat tjera janë tri herë më të mëdha.

Sipas të dhënave statistikore në rrugë të Ballkanit mesatarisht në vit e humbin jetën 1 700 persona, që i bie 141 në muaj.

Shqipëria e shënon numrin më të madh të viktimave të regjistruara në aksidente automobilistike në raport me vendet e Bashkimit Evropian.

Që nga viti 1992 deri në vitin 2013 në Shqipëri e kanë humbur jetën në aksidente automobilistike 6 939 persona.

Nëse në vendet e Bashkimit Evropian, mesatarisht e humbin jetën 51 persona, në vendin tonë e humbin jetën 74 persona, në Shqipëri 119 në vit në çdo një milion banorë.

Detyrë e ne deputetëve është që nëpërmjet punës së komisioneve funksionale të Kuvendit të mbikëqyrjet zbatimi i politikave sikur që është strategjia për sigurinë rrugore të vitit 2015 nëpërmjet 12 fushave sa janë paraparë 130 masa konkrete të sigurisë rrugore, mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, institucioneve dhe autoriteteve përkatëse dhe hisedarëve tjerë të sigurisë së komunikacionit rrugor.

Tash kur jemi në fazën e miratimit të projektligjit për rregullat e sigurisë së komunikacionit rrugor, Projektligji për kundërvajtje, Projektligji për patentëshofer, duhet të përcaktohem edhe për harmonizimin e dispozitave ligjore të nevojës imediate të ndërmarrim të gjitha masat proaktive dhe strikte të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe rregullat e komunikacionit rrugor nga kompetentët dhe hisedarët me qëllim të zvogëlimit të këtyre pasojave tragjike për familjarë dhe viktimave dhe vetë shoqërinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Ganimete Musliu. Nuk është. Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Po e shfrytëzoj, nëse mund të bëhet diçka, ose të punohet normalisht kështu në këtë Kuvend, në këto rrethana, fatkeqësisht.

Dëshiroj ta shtroj një çështje dhe ta propozoj një çështje për Kryesinë e Kuvendit. Siç e dini, muajin që shkoi e festuam 80-vjetorin e lindjes së Adem Demaçit, një ndër personalitet më të shquara, më të rëndësishme shqiptare, një ndër personalitetet kyçe të lirisë së këtij vendi. Siç e dini, siç e dimë të gjithë, ai është edhe fituesi i çmimit ndërkombëtar për paqe, fitues i çmimit "Sarahov". Këto ditë është për ta falënderuar Kuvendin e Kosovës që ka marrë pjesë dhe ka organizuar aktivitete për ditëlindjen e tij. Po ashtu është thënë që duhet të ketë një çmim në emrin e tij. Meqenëse Kuvendi nuk ka ndonjë çmim dhe meqenëse duhen procedura të reja rishtazi të bëhen për këtë, propozoj që Kryesia e Kuvendit të iniciojë themelimi e një çmimi ndërkombëtar për paqe në emër të Bacës Adem dhe kjo të bëhet së shpejti, në mundësinë e parë, në mënyrë që ky viti të jetë një vit i themelimit të një çmimi ndërkombëtar për paqe me emrin e Adem Demaçit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Vazhdojmë me pikën:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentar zgjatë 60 minuta. Për këtë seancë janë 3 pyetje.

Zonja Alma Lama ka pyetje për ministrin Skender Hyseni.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Është me të vërtetë jo për keqardhje, keqardhje është fjalë e pamjaftueshme, por është skandaloze që Kuvendi i Kosovës detyrohet t'i kryejë punimet në një situatë të tillë të gazit lotsjellës, në kushtet e papërgjegjshmërisë totale dhe të mungesës së respektit total nga deputetët, të cilët na hedhin këtë gaz.

Gjithsesi unë do të bëj pyetjen për të cilën jam përgatitur. Pyetja ka të bëjë në lidhje me pezullimin nga puna të dy policëve të Kosovës për shkak se ata e kanë kryer detyrën.

Policët Nazmi Jahiri dhe Ever Sejfullahu janë emrat e policëve në fjalë që janë pezulluar për shkak se e kanë shqiptuar një gjobë ndaj një veture të parkuar në një vend të ndaluar në qytetin e Prizrenit, e cila i përkiste ministrit pa protokoll, zotit Rasim Demiri.

Është evidente se influenza e ministrit në Policinë e Rajonit të Prizrenit ka ndikuar që policët në vend që të falënderohen për punën që e kanë bërë duke i trajtuar edhe zyrtarët si qytetarë të barabartë me të tjerët të ndëshkohen. Prandaj, pyetja ime për ministrin është kjo: Cila është baza ligjore për suspendimin e policëve? A mendoni se Drejtoria e Standardeve brenda Policisë së Kosovës ka rënë në presionin e politikës, duke e arsyetuar veprimin e ministrit dhe si do të zgjidhet kjo çështje?

KRYESUESI: Zoti Hyseni, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuar zonja Lama,

Të nderuar deputetë,

Sipas raportit që kam marrë, pas pyetjes tuaj zonja Lama, del që të gjitha dispozitat ligjore janë respektuar në plotësi në rastin për të cilin ju flisni. Policët e pezulluar sipas procedurës janë trajtuar edhe nga Inspektorati Policor dhe pastaj edhe nga Departamenti.

KRYESUESI: Ndalen ventiatorin, kush është përgjegjës?

MINISTRI SKENDER HYSENI: Por, që ta shkurtoj përgjigjen në pyetjen tuaj, policët e suspenduar janë kthyer në punë pas trajtimit që i është bërë kësaj situatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama, pyetje shtesë.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Zoti kryetar, unë nuk kam pyetje shtesë për ministrin, por më vjen mirë që janë ndërmarrë masat që policët të kthehen në punë, sepse po shihet që kanë qenë të pezulluar padrejtësisht, kështu që më vjen mirë që ka ndodhur kjo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hyseni, e dëshironi fjalën?

MINISTRI SKENDER HYSENI: A nuk ishte pyetje? Ok! Në rregull!

KRYESUESI: Pyetja e dytë për zonjën Lama, për ministrin Arsim Bajrami.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Para pak ditësh, Serbia ka vendosur që t'i kthejë në Kosovë kamionët e mbushur me libra shqip të dedikuar për shkollat shqipe në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, dhuratë e Ministrisë së Arsimit të Kosovës. Në fakt, këto libra kishin qëndruar në kufi që prej 7 muajsh në pritje të përgjigjes së autoriteteve serbe.

Në anën tjetër, Serbia asnjëherë nuk ka pasur ndonjë pengesë që të sjellë në Kosovë libra në gjuhën serbe për shkollat serbe në Kosovë, edhe pse shpesh planprogramet e tyre bien ndesh me ato të miratuara nga Ministria e Arsimit të Kosovës, veçanërisht për mënyrën se si e trajtojnë historinë dhe disa lëndë të tjera shoqërore.

Vetëm një muaj më parë, Kosova e pranoi një kontingjent librash në gjuhën serbe për shkollat dhe bibliotekat në Mitrovicën e Veriut. Prandaj, pyetja ime për ministrin e arsimit, zotin Arsim Bajrami, është: “A do të ketë reciprocitet me Serbinë në raport me këtë çështje dhe a planifikoni t'i drejtoheni BE-së, e cila ndërmjetëson bisedimet për t'u ankuar për sjelljen e shtetit serb në lidhje me këtë çështje?

KRYESUESI: Zoti Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Lama!

Më lejon të ju informoj për çështjen e teksteve mësimore, të cilat si donacion i Qeverisë së Kosovës janë dërguar në Luginën e Preshevës.

Mbi bazën e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës, i cili ka diskutuar dhe e ka miratuar një rezolutë, Ministria e Arsimit ka propozuar në Qeveri që të furnizohen me tekste mësimore të gjithë nxënësit e Luginës së Preshevës nga klasa e parë deri te klasa e nëntë dhe në procedura të rregullta ligjore duke i respektuar plotësisht rregullat e dërgimit të teksteve.

Ne kemi dërguar tekste mësimore në fillim të vitit shkollor në shtator për të gjithë nxënësit e Luginës së Preshevës.

Gjithashtu, kjo çështje është diskutuar 2-3 herë në Bruksel nga ministria Tahiri dhe unë personalisht me autoritetet ndërkombëtare dhe kemi bërë gjithë presionin e mundshëm që këto tekste të mos ndalohen dhe të shkojnë në destinacion, sepse unë e kam vizituar paraprakisht Luginën e Preshevës, e kam parë gjendjen e nxënësve dhe kam parë që ata mësojnë me tekste

plotësisht joprofesionale dhe të papërshtatshme me të cilat jam i sigurt që nuk mëson asnjë nxënës në Evropë.

Fatkeqësisht, me gjithë vullnetin e mirë të bashkësisë ndërkombëtare, flas këtu për autoritetet e larta të Bashkimit Evropian, flas për Ambasadën amerikane e cila gjithë kohën na ka mbështetur për Bashkimin Evropian, për Ambasadën amerikane në Beograd, e cila gjithë kohën na kanë mbështetur, fatkeqësisht Serbia e ka zvarritur këtë çështje dhe nuk e ka lejuar destinacionin të shkojë te vendi.

E nderuara deputete Lama, më lejo të jap një informatë shtesë që librat nuk janë kthyer nga Serbia, por ato janë kthyer me vendim të ministrisë për shkak se ka kaluar afati ligjor 6-mujor deri kur mund të qëndrojnë në terminal dhe ato janë vendosur në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjilan pa e ndërruar destinacionin dhe në momentin kur ta kemi një pëlqim apo një leje, ato përsëri do të dërgohen në Luginën e Preshevës.

Menjëherë pas zvarritjes të këtyre teksteve, si ministër i Arsimit, në konsultim të plotë edhe me autoritetet e Qeverisë së Kosovës, e kam sjellë vendimin, me të cilin kam urdhëruar dhe kam vendosur reciprocitet. Vendimi im u është dërguar të gjitha organeve ekzekutive: Doganës së Kosovës, Policisë së Kosovës dhe kam kërkuar që asnjë tekst mësimor të mos lejohet të hyjë në territorin e Kosovës pa pëlqimin e Ministrisë së Arsimit.

Dhe, Ministria e Arsimit për asnjë tekst nuk ka dhënë pëlqim. Ne e kemi kuptuar pastaj se disa tekste kanë hyrë në mënyrë të paautorizuar dhe të paligjshme dhe kemi kërkuar shpjegim, sidomos nga Zyra Ndërlidhëse e Kosovës në Mitrovicë dhe kemi kërkuar shpjegim për një kontingjent të kufizuar të teksteve. Ministria e Arsimit është e vendosur që të qëndrojë pranë reciprocitetit dhe kërkoj nga agjencitë ekzekutive, Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës që ta ndalojnë cilindo tekst shkollor derisa tekstet tona që janë donacion të shkojnë në destinacionin e planifikuar.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Lama, keni pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti ministër!

Pra shihet se kemi dy probleme madhore. Në njërin anë, Serbia refuzon që tekstet e Kosovës të shkojnë në Luginën e Preshevës dhe, në anën tjetër, jo vetëm që nuk e zbatojnë urdhrin që kanë dhënë institucionet e Kosovës që të mos hyjnë tekstet e tyre, por tekstet e tyre gjithashtu janë edhe skandaloze për shkak të përmbajtjes së tyre, pra dy probleme madhore.

Kështu që përveç thyerjes së urdhrit, që kam dëshirë ta di se kur është dhënë ky urdhër nga ju, sepse viti shkollor gati është në përfundim, domethënë ky urdhër do të duhej të ishte dhënë që atëherë kur janë nisur tekstet për në Luginën e Preshevës. Çfarë po ndërmerret ministria që së paku në lidhje me përmbajtjen e teksteve që mësojnë nxënësit serbë të ndërmerret diçka dhe a jeni ankuar në UNESCO, sepse ky është institucioni që besoj që do të duhej të njoftohej për gjuhën e urrejtjes, për problematikën që mësohet në këto shkolla.

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete!

Vendimi me të cilin kam urdhëruar reciprocitetin është sjellë menjëherë, pesë ditë pas ndalimit të shkuarjes së librave në destinacion. Vendimi ka qenë i botuar dhe unë jam i gatshëm të ju jap në cilindo moment që ta shihni që ai është bërë në fillim të vitit shkollor.

Sa u përket programeve mësimore për shkollat serbe, është e vërtetë se ato kanë përmbajtje të papërshtatshme. Këtu e kemi një çështje që edhe vetë plani i Ahtisarit dhe Ligji për arsimin parauniversitar lejon një lloj fleksibiliteti, por ky nuk është vetëm një proces i monitorimit, por është edhe një proces politik dhe ne tani e kemi ndërtuar një strategji që të fillojmë integrimin e këtyre shkollave brenda sistemit arsimor, jo nëpërmjet masave represive, por nëpërmjet një kontrolli të vendosur që secila shkollë ta respektojë orarin, kalendarin shkollor, ta respektojë legjislacionin e Kosovës dhe ky proces do të fillojë së monitoruari së afërmi tani edhe nëpërmjet Inspektoratit të Arsimit, i cili do ta fillojë një lloj inspektimi të shkollave të cilat nuk e pranojnë programin mësimor, në mënyrë që të fillojmë integrimin e tyre në të gjitha nivelet.

Siç e dini, me Ligjin për arsimin e lartë, që së shpejti do të vijë në diskutim, ne e kemi integruar Universitetin e Mitrovicës së Veriut, i cili për herë të parë parashihet si kategori ligjore, si Universitet Publik i Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zoti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e kaluar në kuadër të prioritetëve të saj e ka pasur edhe ndërtimin e objekteve shkollore, me qëllim të krijimit të hapësirave të mjaftueshme për zhvillimin normal të procesit edukativo-mësimor. Në komunën prej nga vij unë janë dy objekte shkollore që kanë nisur të realizohen që nga viti 2013, objekti i shkollës fillore “Dëshmorët e Qyqavicës” në Qirez, dhe objekti i gjimnazit “Hamëz Jashari” në Skenderaj, të cilat ende nuk kanë hyrë në fazën përfundimtare. Edhe këtë vit është ndarë një shumë e mjeteve për t’i vazhduar këto dy projekte, mirëpo ato nuk mjaftojnë për përfundimin e tyre. Unë e kam të qartë që janë projekte në bashkëfinancim me Komunën.

Pyetja ime për ministrin është: Zoti ministër, deri ku ka shkuar ky proces dhe kur pritet të përfundojë ndërtimi i këtyre objekteve shkollore? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet Ymeri!

Të falënderoj për pyetjen. Këto dy projekte që ju i ngrehët janë projekte të përbashkëta të Qeverisë komunale dhe Ministrisë së Arsimit dhe procedurat janë zhvilluar kryesisht në Komunën e Skenderajt.

Ministria e Arsimit me kërkesën e Komunës i ka përkrahur financiarisht këto dy projekte në vlera të caktuara, për këtë arsye se ndërmjet ministrisë dhe Komunës së Skenderajt është

ndërtuar marrëveshja e mirëkuptimit. Sipas kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit, ministria dhe Komuna e Skenderajt kanë marrë për obligim të participojnë në financimin e gjimnazit “Hamëz Jashari” në Skenderaj në vlerë 1 milion e 100 mijë euro, kurse vlera totale e kontratës shkon diku në 1 milion e 900 mijë euro.

Për shkollën fillore në Qirez ministria ka participuar me 200 mijë euro, derisa vlera e kontratës është 789 mijë euro. Këtë vit, Qeveria e Kosovës i ka ndarë ministrisë për projektin e shkollës në Qirez edhe 200 mijë euro, por jemi në procedurë të gjetjes së mundësisë për lidhjen e një marrëveshjeje shtesë për vazhdimin e financimit të këtij projekti. Sa i përket kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit, ministria i ka kryer obligimet e veta dhe nuk mund të dalë jashtë saj.

I nderuar deputet Ymeri!

Unë i kam vizituar këto dy shkolla. Gjithashtu e kemi ndarë edhe një fond për përfundimin e disa shkollave të mëhershme dhe të jeni të sigurt se bashkë me autoritetet e Komunës së Skenderajt do të takohemi dhe do të punojmë së bashku që sa më shpejt të përfundojnë këto dy shkolla, sidomos investimet në gjimnazin “Hamëz Jashari”, që është një nga shkollat më të mëdha në komunën e Skenderajt dhe do të punojmë që ato të përmbillen në një afat sa më të shpejtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ymeri?

ABDYL YMERI: Faleminderit!

Cilat janë mundësitë buxhetore që me rishikim të buxhetit të ndahen mjete shtesë, në mënyrë që këto dy projekte të jenë të përfunduara dhe procesi mësimor të fillojë më 1 shtator në objekte të reja. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet!

Edhe para rishikimit të buxhetit po e shikojmë mundësinë e gjetjes, sepse e kemi një pozicion buxhetor që nuk është i definuar, por që mund të përdoret për shkolla. Do të bëj përpjekje që edhe para rishikimit të gjejmë mjete që të kryhen këto shkolla, por ju siguroj që bashkë me ju në rishikim do të punojmë që këto dy shkolla të jenë të gatshme për vitin e ardhshëm shkollor.

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që nuk ka pyetje tjera sa i përket kësaj seance.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se e kemi një propozim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet, zotin Naser Osmani, që ta paraqesë dhe arsyetojë propozimin.

NASER OSMANI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Komisioni për Buxhet dhe Financa në cilësinë e Komisionit Funkcional e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe në pajtim me nenin 42.2 të Rregullores së Kuvendit kërkojmë që të plotësohet

rendi i ditës në seancën e sotme plenare me këtë pikë: *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.*

Është e nevojshme dhe urgjente që kjo pikë të shqyrtohet në seancën e sotme, pasi kompletimi i anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe funksionalizimi i plotë i këtij organi është një ndër kriteret që duhet plotësuar për liberalizimin e vizave. Zoti nënkryetar i Kuvendit, në emër të komisionit, kërkoj që kjo pikë të renditet menjëherë si pikë e parë që fillojë me rendin e ditës.

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që s'ka nevojë për deklarime, por votojmë formalish. Në sallë janë 62 deputetë. A ka dikush kundër kërkesës së Komisionit për Buxhet? Nuk ka! Atëherë, mendoj që duhet të renditet në rendin e ditës. Kemi 62 deputetë, meqë nuk është deklaruar askush kundër, prandaj konstatoj që duhet të hyjë në rendin e ditës si pikë e veçantë - pikë e katërt e rendit të ditës. Faleminderit!

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

A keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 14 dhjetor 2015, në orën 10:00 dhe në orën 22:00, në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 19 shkurt 2016, në orën 10:00 dhe në orën 19:00, si dhe në procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 26 shkurt 2016?

Nuk ka vërejtje. Ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 14 dhjetor 2015, në orën 10:00 dhe në orën 22:00, në seancën e mbajtur më 19 shkurt 2016 nuk janë proceduar.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 14 dhjetor 2015, në orën 10:00 dhe në orën 22:00, procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 19 shkurt 2016, në orën 10:00 dhe në orën 19:00, si dhe procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 26 shkurt 2016.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Qeveria e Republikës së Kosovës ia ka propozuar Kuvendit shkarkimin e Bajram Zogianit nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë propozimin.

Kush do ta bëjë propozimin në emër të Qeverisë? Atëherë, zoti Osmani e ka fjalën, meqenëse nga Qeveria nuk e ka kërkuar kurrkush fjalën. E ftoj zotin Osmani si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojë propozimin.

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në bazë të paragrafit 4 të nenit 101, të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/ L-092, Qeveria i propozon Kuvendit shkarkimin e kryetarit, apo një anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, nëse ai vepron në kundërshtim me etikën profesionale që ndërlidhet me detyrën e tij.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, Qeveria i ka propozuar Kuvendit shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të OSHP-së për shkak se ndaj të njëjtit është ngrehur aktakuzë nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, është arrestuar dhe gjendet në paraburgim për veprë penale që bie ndesh me etikën profesionale që ndërlidhet me detyrat e tij.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 7. 3. 2016 e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për shkarkimin e z. Bajram Zogianit nga pozita e anëtarit të OSHP-së dhe ka vlerësuar se propozimi i Qeverisë është në pajtim me nenin 101, paragrafi i 4 të Ligjit nr. 04/ L- 042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-092 dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e propozim-vendimit të Qeverisë për shkarkimin e zotit Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të OSHP-së.

Shkarkimi i zotit Zogiani nuk paragjykon në zhvillimin dhe përfundimin e procesit gjyqësor ndaj tij. Faleminderit!

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Unë ju kërkoj falje të gjithë deputetëve në Kuvend! Ju kërkoj falje vetëm për një çështje: nuk kemi nevojë, ne jemi në rend dite, e kam të qartë që s'kemi të drejtë, as unë s'kam të drejtë ta ndërpres rendin e ditës...

Unë mendoj që është e domosdoshme kjo ndërhyrje imja dhe unë, me përgjegjësinë time, duhet t'ia jap fjalën zotit Ismajl Kurteshi që të thotë atë që do ta thotë dhe pastaj vazhdojmë me seancë. Ju kërkoj falje të gjithëve! Zoti Kurteshi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Deputetë të nderuar!

Më lejoni që në emër të opozitës së bashkuar të ju drejtohem juve me kërkesën që të kontribuoni në normalizimin e situatës në Kosovë. Në Kosovë nuk ka situatë normale që nga shtatori dhe shkaktarët ju i dini: janë ata që kanë nënshkruar marrëveshje për të cilat Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se janë në kundërshtim me Kushtetutën. Përgjegjësinë për normalizimin e kësaj situatë e bëni edhe ju secili veç e veç, edhe si grupe parlamentare.

Derisa Isa Mustafa të jetë në krye të Qeverisë, njeriu i cili e ka shkelur Kushtetutën dhe këtë nuk po e themi ne, këtë e ka thënë Gjykata Kushtetuese më 23 dhjetor dhe ai e ka pranuar që e ka shkelur këtë Kushtetutë, por nuk po pranon ta tërheqë marrëveshjen e cila ka shkaktuar shkelje, e ka dëmtuar vendin, dhe po vazhdon ta dëmtojë vendin, normalitet nuk do të ketë. Ne, bashkë me qytetarët e Kosovës, të cilët që nga ky vend dhe ky moment i ftoj që të na bashkëngjiten në protestën që e kemi paralajmëruar që do të jetë më 26 mars, në orën 14:00, në sheshin "Skënderbe", me qëllim të kundërshtimit të Qeverisë së Kosovës, ju ftojmë edhe ju që ta jepni kontributin tuaj, edhe në Kuvend, edhe jashtë Kuvendit, që këtë Qeveri të papërgjegjshme dhe të korruptuar ta çojmë në shtëpi.

Prandaj, edhe një herë kërkoj që t'i ndërmerrni veprimet tuaja, të cilat duhet t'i ndërmerrni. Kërkojmë nga Isa Mustafa i cili ka shkel Kushtetutën të japë dorëheqje dhe të fillojë puna ashtu siç duhet në Kuvendin e Kosovës. Ne tani po shkojmë, ju mëshojuni tupanëve, por normalitet nuk do të ketë derisa situata nuk normalizohet me shkuarjen e Qeverisë.

Unë tash i ftoj kolegët e mi të shkojmë dhe do ta njoftojmë opinionin. Dhe, në fund, skanerët duhet t'i dërgoni në Qeveri që ta skanoni korrupsionin e Isa Mustafës dhe të kësaj Qeverie. Nuk ka nevojë të blihen skanerë, se ne nuk do të jemi objekt i skanerëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu, faleminderit që më preve në besë! Atëherë, unë i kërkoj falje zotit Mustafa që ia hodhën një çik ujë, por s'është ndonjë problem.

Ne jemi këtu, jemi pozitivë e fuqishëm, do të vazhdojmë me seancën. Besoj që nuk ka nevojë që të diskutojmë për këtë çështje. Vazhdojmë me seancën. Ademi e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Pajtohem me përpjekjet tua dhe tonat të gjitha të përbashkëta për të kontribuar, për të mos lejuar eskalimin e situatës, për të bërë përpjekje dhe për ta dhënë maksimumin tonë të mundshëm në fuqizimin e shtetit, në funksionalizimin dhe në mbështetjen e institucioneve tona, mirëpo kjo që është duke ndodhur në Parlamentin e Kosovës dhe në vendin tonë tani e shtatë muaj rresht është diçka e paparë, është e kundërligjshme, është e papranueshme dhe është e dënueshme.

Këtu në këtë institucion më të lartë të vendit vendimmarrës, këta deputetë e këto deputete i janë nënshtruar një dhune të paparë, ku u është rrezikuar edhe jeta e tyre, por e kanë dhënë maksimumin e mundshëm që të mos lejojnë tentimin e bllokimit dhe shkatërrimin e shtetit. Shpreh keqardhjen për një pjesë të opozitës që ka hyrë në agjendë të huaj, të atyre të cilët e kanë mision shkatërrimin e shtetit.

Unë i bëj thirrje edhe kryeministrit, edhe organeve të drejtësisë, edhe organeve të rendit që ta japin maksimumin e vet dhe t'i respektojnë ligjet, ta respektojnë Kushtetutën dhe t'i kryejnë e t'i përmbushin obligimet e tyre ligjore. Ju lutem, a ka krim më të madh, a ka absurditet më të madh se sa në shtet të sulmohet kryeministri i vendit, të arrestohen njerëzit dhe pas tri, katër orë, apo pas një dite të lirohen aktorët?

I bëj pyetje vetvetes, ju dhe çdo qytetari të Republikës së Kosovës, a është drejtësi kur gjykatat tona u krijojnë mundësi atyre, të cilët e kryejnë krimin të dënuar dhe u mundësojnë për t'u kthyer prapë në vendin e krimit për të vazhduar veprën e njëjtë?

Ku janë duke na çuar këto veprime? A duam të kemi shtet, a s' duam të kemi shtet? I kemi fyer të gjithë miqtë tanë. E kemi lënduar shpirtin, zemrën e çdo qytetari të Republikës së Kosovës që e do, që mendon për vendin e vet, për familjen e vet, për fëmijët e vet, për perspektivën e fëmijëve të vetë.

Prandaj, kjo është e palejueshme dhe mendoj, kolegë të nderuar deputetë, ne nuk mund të vazhdojmë deri në pafundësi në këtë formë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Grabovci! Zoti Mustafa e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Në të vërtetë, nuk shoh asnjë arsye që opozita të sillet kështu, nuk shoh asnjë arsye që opozita të na sulmojë, qoftë brenda në Kuvend, qoftë jashtë Kuvendit, dhe po ashtu nuk shoh arsye që shteti të mos funksionojë ashtu si duhet të funksionojë. Nuk jemi ne të Qeverisë që duhet të tregojmë dhe instruojmë institucionet e vendit, edhe ato të drejtësisë, edhe të tjerat, se si duhet ta bëjnë punën e tyre, por të gjithë ne duhet të kërkojmë që shteti të funksionojë dhe çdonjëri të përgjigjet para ligjit për veprimet e tyre.

Unë jam kryeministër i vendit, nuk jam shenjë që kujt t'i teket të gjuajë në mua këtu, as brenda Kuvendit, as jashtë Kuvendit, dhe mendoj që këtë s'duhet ta lejojnë organet e drejtësisë dhe ata që duhet të merren drejtësi. S'duhet të lejojnë as të më sulmohet shtëpia. Unë s'kam dashur të deklarohej publikisht, sepse kam menduar që organet duhet ta bëjnë punën e tyre, por në qoftë se një shtëpi e kryeministrit në Kosovë sulmohet me shishe molotovi dhe heshtin të gjithë, atëherë diçka nuk është në rregull në këtë vend.

Në qoftë se njerëzit e përsëritin veprën pandërprerë këtu në Kuvend dhe i pengojnë 120 deputetë që ta bëjnë punën e tyre, atëherë s'mund të themi se të gjithë ne po bëjmë detyrën tonë, sepse Kuvendi duhet të funksionojë dhe do të funksionojë, Qeveria duhet të funksionojë dhe ju garantoj se ka me funksionuar.

Sikur unë ta konsideroja veten si shkelës i Kushtetutës, ju garantoj se sot do të dilja para jush dhe do t'u kërkoja falje juve, Lidhjes Demokratike të Kosovës në krye të së cilës jam, qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe do tu thosha se është shkelur Kushtetuta dhe si konsekuencë e shkeljes së Kushtetutës unë e bart përgjegjësinë time. Unë ju garantoj se nuk e kemi shkelur asnjë pikë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, asnjë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka dhënë mendimin e saj lidhur me marrëveshjen, Gjykata Kushtetuese ka thënë, se marrëveshja e parë është bërë normë juridike dhe ajo duhet të zbatohet, sepse me Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes së parë Kosova ka marrë obligim që ta themelojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Ndërkaq, Gjykata Kushtetuese ka thënë se si duhet të themelohet ky asociacion, në mënyrë që të mbrohet fryma kushtetuese, sepse Gjykata Kushtetuese nuk e ka interpretuar asnjë nen të Kushtetutës se është shkelur, por ka thënë se fryma kushtetuese është kështu dhe se asociacioni duhet të bëhet mbi bazën e frymës kushtetuese. Dhe, unë dhe Qeveria kemi marrë për obligim që më tutje ta respektojmë pikë për pikë Vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Vetë fakti që në marrëveshjen për parimet, jemi përcaktuar që këtë marrëveshje t'ia dërgojmë Gjykatës Kushtetuese dhe këtë e ka pranuar Brukseli dhe e ka pranuar edhe pala serbe, flet se ne kemi qenë të kujdesshëm ashtu që në asnjë moment të mos shkelet Kushtetuta, se nuk është shkelje Kushtetutës në qoftë se në marrëveshje thuhet, se marrëveshja i dërgohet Gjykatës Kushtetuese dhe se Asociacioni do të themelohet mbi bazën e vërejtjeve, sugjerimeve dhe mendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, kjo nuk mund të shërbejë si kauzë, nuk mund të shërbejë si e drejtë për t'i ftuar qytetarët që ta sulmojnë vendin e tyre, ose e drejtë që opozita me mjete të dhunshme të kryejë veprime.

Unë e ftoj opozitën prapë që të kthehet, të marrë pjesë në debat, që t'i thotë të gjitha vërejtjet që i ka lidhur me asociacionin, lidhur me demarkacionin, lidhur me mënyrën se si ne do ta zhvillojmë dialogun në të ardhmen, sepse ata përfaqësojnë një pjesë të votës së qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe qytetarët e Republikës së Kosovës nuk e kanë votuar asnjë deputet, as ata të opozitës, për të ardhur e gjuajtur gaz lotsjellës në sallën e Kuvendit, ata i kanë votuar që të marrin pjesë këtu dhe që në mënyrë konstruktive t'i paraqesin mendimet dhe të kundërshtojnë, sepse kanë të drejtë të kundërshtojnë pozitën, por atë ta bëjnë me fakte, me argumente dhe në mënyrë demokratike. Nuk është mënyrë demokratike kjo si po veprojnë njerëzit e opozitës.

Prandaj, në asnjë rast nuk është cenuar asnjë nen, asnjë pikë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në asnjë rast Qeveria nuk do ta bëjë këtë dhe as që e ka bërë, ne do të jemi përgjegjës plotësisht që ta implementojmë Kushtetutën dhe çdo akt që e nxjerrim të jetë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por ftojmë opozitën, ftojmë edhe qytetarët, që ata të jenë ashtu siç kanë qenë deri më sot, përkrahës të ndërtimit të vendit, të zhvillimit të demokracisë dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës, sepse jashtë kësaj ne nuk mund të veprojmë dhe nuk do të veprojmë. Ne si Qeveri do të jemi shumë përgjegjës para jush dhe t'i kryejmë programin dhe përcaktimet që i kemi dhënë këtu dhe po ashtu, edhe premtimet që ua kemi dhënë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa!

Unë besoj se për këtë çështje pas fjalës së kryeministrit mund të flasim të gjithë, por të gjithë e kemi një qëllim, një ide, besoj që do të përfundojë edhe kjo odiseadë e gazit dhe e gjuajtjes. Jam për ata që të futemi në rend të ditës. Zonja Sahatqija e ka kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe më pastaj nuk ka debat lidhur me këtë çështje.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Mendoj se në rend të parë ishte shkelje e Rregullores, që një pikë e cila nuk u përfundua, u ndërpre dhe hymë në një pikë tjetër, e cila nuk kishte fare lidhje me rendin e ditës.

E dyta, mendoj se deri më tash kemi qenë për muaj të tërë të helmuar prej gazit në Kuvendin e Kosovës. E di se shumë prej deputetëve ankohen për probleme me frymëmarrje, po përsëri me dhembje koke e me probleme të tjera shëndetësore, duke marrë doza të njëpasnjëshme në Kuvendin e Kosovës. Por, pa marrë parasysh atë, ne po qëndrojmë këtu dhe po tentojmë që të arsyetojmë atë votën, të cilën qytetarët na e kanë dhënë dhe për të cilën ne jemi betuar, së bashku edhe me një deputet i cili sot e dha betimin, se do të punojmë për Kosovën.

Ne nuk kemi një shtet rezervë, që ky... çfarëdo që të ndodhë me këtë, të shkojmë diku tjetër. Secili prej nesh e di që ka mjaftë probleme, por ato probleme mund të zgjidhen me bashkëpunim pozitiv e opozitiv. Çdoherë në Kuvend ka pasur pozitiv dhe opozitiv dhe secila palë përmes mjeteve demokratike ka tentuar që të japë kontributin dhe që këto probleme, me të cilat ne si shtet i ri po ballafaqohemi, t'i tejkalojmë dhe ta ndërtojmë Kosovën, se e kemi vetëm këtë, ta ndërtojmë në një shtet të duhur.

Prandaj, shpresoj që opozita në vend të thirrjes për aktivitete jashtë Kuvendit, të kthehet në Kuvend dhe të japë kontributin e vet në mënyrë demokratike për të përmirësuar gjendjen në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Rregulloren e interpretoj unë sot dhe unë mendoj, që kur e kërkojnë fjalën kryetarët e grupeve është e drejtë e tyre që të flasin. Edhe ata kanë qenë tri grupe parlamentare që e kanë kërkuar një fjalë, në një situatë, po them, jo të këndshme dhe më mirë ishte që t'ua jap fjalën se sa të bëjmë përplasje këtu. E kryen fjalën e tyre, dolën, e lagën kryeministrin pakë me ujë... i kërkoj falje, në qoftë se kam ndikuar në atë që t'i afrohen me ujë ata... opozita. Besoj që ma falni, ose edhe në mos ma falshi, nisni procedurat... çka mund të bëj unë!?

Zoti Naser Osmani e ka fjalën. E ke kryer? Atëherë, kërkoj që lidhur me propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të deklarohemi. Në sallë janë 70 deputetë përfaqësues, 74 ish-in, 70 janë. Kërkoj deklarin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës fjalën e ka zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet Qeveritar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ka ardhur në përfundim, që të miratojë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e zotit Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit publik. Ftoj anëtarët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që ta përkrahin rekomandimin, që ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, zoti Zemaj është paraqitur.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar rekomandimin në fjalë, e konsideron çështje të rëndësishme në përpjekje të Qeverisë për pastrimin e institucioneve nga çdokush që është në kundërshtim me Ligjin apo që është pjesë e hetimeve, të cilat kanë të bëjnë qoftë me detyrën, qoftë me aktivitete të tjera, që mund të bien ndesh me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Ne njëherësh i bëjmë ftesë, apo i bëjmë thirrje Qeverisë, që në të gjitha institucionet që janë dhe që janë nën kompetencë të tyre, askush të mos jetë i amnistuar, po që se është pjesë e proceseve hetimore, apo është pjesë e procesit të ngritjeve të aktakuzave.

Grupi Parlamentar i LDK-së përkrahë këtë rekomandim të Komisionit Funkcional dhe njëherësh kërkon që edhe kjo të jetë pjesë e rekomandimit për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është, AAK nuk është, Lista Serbe. Nuk deklarohen. Nisma nuk është. “6+”-i, zoti Paçaku.

KUJTIM PAÇAKU: I nderuar kryetar,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah rekomandimin e dalë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! E dëshiron ndokush fjalën? Nuk është paraqitur askush.

Në sallë janë 66 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët, që të përgatiten për votim. Votojmë tani! Ju lutem të paraqiteni kush është pa kartelë, një, dy... kush tjetër s'ka kartelë? Dëshiroj ta di paraprakisht, se kush është pa kartelë.

Atëherë, pa kartelë është vetëm një. Gospodo, jel u redu? A e ke në rregull? A ka dikush që ka probleme me kartelë? Nuk ka.

Atëherë, e përsëris votimin, 1 deputet është pa kartelë. Votojmë tani!

Ju pa kartelë, jeni për apo kundër? Për! Domethënë, 66 vota për janë me kartelë dhe një pa kartelë – 67 vota për. Konstatoj, që Kuvendi shkarkoi Bajram Zogianin nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ta them edhe se s'ka asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Faleminderit!

5. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Qeveria e Republikës së Kosovës ia ka parashtruar Kuvendit propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Kryetari i Kuvendit ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendit t'i propozojë tre gjykatës për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka propozuar tre gjykatës, të cilët do ta përbëjnë Organin Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Tani kërkoj deklarinimin e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së a ka dikush që dëshiron të deklarohet. Duhet ndjekur procedurat. LDK-ja nuk dëshiron. "Vetëvendosja" nuk dëshiron, AAK-ja jo, Lista serbe jo, "Nisma" jo, "6+"-i jo.

Atëherë, lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Në sallë janë 65 deputetë. Votojmë tash!

Faleminderit! Pa kartelë, a je për? Po! Atëherë, konstatoj që me 61 vota për, në fakt 62, se një është pa kartelë, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi formoi Organin Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik në këtë përbërje:

1. Valdete Dakaj,
2. Asllan Krasniqi dhe
3. Nebojsha Boriçiq.

Ngarkohet Organi Përzgjedhës i Pavarur që në pajtim me dispozitat e Ligjit për prokurimin publik ta shqyrtojë propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe dy anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportim me rekomandime. Faleminderit!

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotin Stavileci, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Stavileci, e keni fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Ju paraqes për aprovim Projektligjin për gazin natyror për të përafruar kornizën legislative të këtij sektori me zhvillimet në nivelin e Bashkimit Evropian.

Kosova si palë kontraktuese e traktatit të komunitetit të energjisë është ligjërisht e obliguar të harmonizojë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të domosdoshme për të qenë në përputhje me pakon e tretë të ligjeve, me qëllim të përshtatjes së legjislacionit nacional me atë të Bashkimit Evropian.

Mbi këtë bazë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka hartuar Projektligjin për gazin natyror, gjithmonë duke marrë parasysh direktivën përkatëse në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, si dhe Rregulloren mbi kushtet për qasjen në rrjetet e bartjes së gazit natyror.

Çështje e trajtuar në këtë projektligj janë: solidariteti rajonal, të cilat nuk kanë ekzistuar në legjislacionin e mëparshëm. Kjo dispozitë përcakton bashkëpunimin në mes palëve kontraktuese për të promovuar solidaritetin rajonal dhe bilateral. Gjithashtu, çështje tjetër e trajtuar në këtë projektligj është edhe shthurja dhe certifikimi i operatorëve, si dhe parimet e shthurjes, pavarësia e Autoritetit Rregullativ. Pakoja e tretë fuqizon autorizimet dhe pavarësinë e rregullatorit dhe shton një numër obligimesh për strukturën e tyre organizative.

Po ashtu, përcaktohet edhe roli i rregullatorit duke përfshirë monitorimin dhe rregullimin e mëtutjeshëm të operimit të tregut të brendshëm, si dhe për të promovuar konkurrencën efektive. Disa dispozita për mbrojtjen e konsumatorëve, sidomos mbrojtje të veçantë për konsumatorët e cenueshëm.

Me këtë rast, të nderuar deputetë, duke marrë parasysh rëndësinë e materies, që ka ky projektligj, si dhe duke marrë parasysh kërkesat e pakos së tretë si dhe nevojën e krijimit të kushteve ligjore dhe infrastrukture, që duhet të krijojnë palët kontraktuese të komunitetit të energjisë, në mënyrë që të mundësojnë funksionimin e një tregu të përbashkët në regjion, rekomandoj të bëhet miratimi i këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Mustafa, që ta marrë fjalën lidhur me ligjin.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues!

I nderuari kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka trajtuar këtë projektligj dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë në leximin e parë në parim. Komisioni ka vlerësuar se Projektligji mbi gazin natyror përkufizon në mënyrë të saktë dhe në harmoni me kërkesat e Komunitetit Evropian të Energjisë rolin e aktorëve të ndryshëm në këtë sektor dhe në harmoni me sigurimin e një konkurrence fer dhe në dobi të konsumatorëve në tregun e gazit natyror, e organizon më mirë këtë sektor, funksionimin e këtij sektori e bën më transparent dhe më gjithëpërfshirës, gjithashtu lehtëson qasjen në treg dhe në rrjetet ndërkombëtare, si dhe këmbimin ndërkufitar e që do të fitojë përkrah rëndësia sidomos, me zhvillimet e korridoreve të reja të gazit natyror, që kanë një rëndësi strategjike për rajonin.

Faleminderit! Ju ftoj që ta aprovoni në parim në leximin e parë këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, dëshiron dikush ta marrë fjalën? Zoti Besim Beqaj, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes Ligjin për gazin natyror. Është një ligj i një rëndësie të veçantë, sepse shkon në drejtim të plotësimit të kushteve të cilat i ka vendi ynë në raport me Bashkimin Evropian dhe me traktatin e energjisë, prandaj ne thërrasim që ta miratojmë në parim, ndërsa kontributin tonë do ta japim në mes të dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Blerim Grainca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

BLERIM GRAINCA: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe mendojmë se rregullon një fushë të rëndësishme, duke i kushtuar rëndësi të veçantë çështjeve që lidhen me operimin e tregut, pavarësisë së rregullatorëve, konkurrencës në treg dhe me theks të veçantë në mbrojtjen e konsumatorëve. Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së është pro dhe ju fton që ta votojmë ligjin në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista Serbe, Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala potpredsedniče!

Poštovane dame i gospodo narodni poslanici,

Poštovani Vladin kabinetu,

Poslanička Grupa Srpske Liste razmotrila je pažljivo Nacrt-zakona o prirodnom gasu i s obzirom da će ovaj nacrt-zakona da se primenjuje u cilju utvrđivanja pravila organizaciji rada sektora prirodnog gasa, definisanja nacionalnih pravila za skladišta. Uzimajući u obzir i posebne karakteristike domaćeg i regionalnog tržišta, Poslanička Grupa Srpska Lista u načelu podržaće ovaj nacrt-zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”-i, zoti Paçaku.

KUJTIM PAÇAKU: I nderuari kryesues,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” në parim e përkrah këtë ligj, kurse kontributin do ta japë ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. Lus që deputetët të kthehen në sallë. Nuk kemi kuorum. Shihni, dikush kush është jashtë... Procedojmë me votim. Faleminderit që u kthyet!

Në sallë janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Unë ju lus që të keni kujdes me kartelat dhe të votoni se në qoftë se votojnë 61 deputetë, nuk mund të konsiderohet i votuar projektligji.

Po e përsëris edhe një herë votimin. Kanë votuar vetëm 57 deputetë.

E përsëris votimin dhe votojmë tani:

Faleminderit!

Konstatohet se Kuvendi me 64 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim e miratoi në parim Projektligjin për gazin natyror.

Ngarkohet komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin për Zhvillim Ekonomik, zotin Stavileci, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të pakos së tretë të këtyre katër ligjeve të rëndësishëm, tash paraqes para jush për shqyrtim dhe aprovim Projektligjin për rregullatorin e energjisë.

Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmisionit në sektorin e energjisë, procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.

Kosova si palë kontraktuese e Traktatit të komunitetit të energjisë, është ligjërisht e obliguar t’i harmonizojë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të domosdoshme për të qenë në

përputhje me pakon e tretë me qëllim të përshtatjes së legjislacionit nacional me atë të Bashkimit Evropian.

Çështjet të cilat trajtohen në këtë projektligj, ashtu sikur në Projektligjin e kaluar, janë promovimi i bashkëpunimit rajonal dhe solidariteti rajonal, të cilat nuk kanë ekzistuar në legjislacionin e mëparshëm dhe këto janë në përputhje të plotë me frymën e re të pakos së tretë të ligjeve për energjinë.

Kjo dispozitë përcakton bashkëpunimin në mes palëve kontraktuese për të promovuar solidaritetin rajonal dhe bilateral për bashkëpunimin në mes të autoriteteve rregullative të palëve kontraktuese.

Pakoja e tretë po ashtu fuqizon autorizimet dhe pavarësinë e rregullatorit dhe shton një numër obligimesh për strukturën e tyre organizative.

Gjithashtu përcaktohet edhe roli i rregullatorit duke përfshirë monitorimin dhe rregullimin e mëtutjeshëm të operimit të tregut të brendshëm si dhe për të promovuar konkurrencën efektive.

Me këtë rast, të nderuar deputetë, marrë parasysh rëndësinë edhe të kësaj materie që e trajton ky projektligj, ju rekomandoj që ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka zoti Mustafa, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Komisioni e ka shqyrtuar gjithashtu edhe këtë ligj që bën pjesë në pakon 3 të harmonizimit të ligjeve me komunitetin e energjisë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë në parim.

Ky ligj, siç ceku edhe ministri, rregullon më mirë kompetencat, mënyrën e funksionimit, si dhe mënyrën e rregullimit të këtij sektori shumë të rëndësishëm.

Komisioni duke e aprovuar në parim, ka diskutuar gjithashtu edhe për nevojën që në leximin e dytë të shihet më mirë mënyra se si do të zbatohen rekomandimet e Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve të bordeve të agjencive të pavarura si dhe rregullimin e përgjegjësisë së anëtarëve të Bordit të Rregullatorit për performancën e këtij organi dhe gjendjen në këtë sektor, sidomos në rastet kur raportet vjetore të Rregullatorit për energji nuk aprovohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, a e do ndokush fjalën? Zoti Raif Qela!

RAIF QELA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zoti kryeministër, kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për Rregullatorin e energjisë dhe konsideron që atë duhet miratuar në leximin e parë në mënyrë që në fazën e më tutjeshme të punojë në amendamentimin e tij eventual. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit kryesues i seancës!

Kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë, kryeministër,

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, pakon e ligjeve që i kemi para vetes për sot në fushën e energjisë, ka zhvilluar në fazën e parë të diskutimeve në parim dhe i përkrahim, në mesin e tyre edhe të këtij projektligji për Rregullatorin e energjisë, nisur nga faktet se plotësimet dhe ndryshimet në këtë projektligj i japin një përmbajtje të re e cila është kompatibël me kërkesat të cilat shtrohen nga standardet e reja dhe ndryshimet e reja që kanë ndodhur në fushën e energjisë në këtë sektor dhe traktatin apo direktivet tjera të Bashkësisë Evropiane, por në mënyrë të veçantë pranon detyrat shtesë që dalin për Rregullatorin e energjisë për të rregulluar fushën e këtij sektori në vendin tonë, por edhe në pajtim me kërkesat dhe ndryshimet tjera.

Prandaj, ne e përkrahim në parim dhe në procedim do të marrim pjesë së bashku me kolegët tjerë që realisht kjo pako e projektligjeve të ketë një përmbajtje sa më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Listës serbe, zoti Simiq e ka fjalën!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa Srpske liste razmotrila je također Nacrt zakona o rregullatoru energije i mi čemo svoj doprinos dati kroz funkcionalne komisije za ekonomski razvoj kako bi ovaj nacrt zakona na drugo čitanje imao sasvim novi sadržaj i kako bi bio prihvatljiv i u skladu sa zakonima Evropske zajednice. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zoti Damka!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për Rregullatorin e energjisë dhe Projektligjin për energjinë elektrike dhe tjerët, pasi që janë ngjit me pako, por po dua të ngre një shqetësim lidhur me rregullatorin e energjisë dhe besoj se është koha që të përmirësojmë një gabim i cili deri tani është aplikuar për objektet e kultit, për xhamitë tona, për kishat dhe për teqetë.

Prandaj, siç e dini edhe ju, këto objekte janë duke paguar rrymën me një tarifë të cilat janë aplikuar për biznese, për ndërmarrjet dhe për firmat e eksportit dhe importit.

Unë besoj se xhamitë tona nuk janë fitimprurëse, nuk janë biznese, ashtu që besoj që nuk duhet ngarkuar me tarifa të cilat nuk e meritojnë. 20 vjet janë duke paguar me një çmim shumë të lartë dhe ju e dini se xhamitë tona janë duke mbledhur pare prej xhemitit tonë çdo javë.

Unë besoj se këtë herë kemi hapësirë të përmirësojmë këtë gabim sepse 20 vjet është duke u përcjellë ky gabim nëpër objekte të kultit.

Për ujin ne e kemi kryer me Zyrën e Rregullatorit të Ujërave dhe unë besoj që këtë herë edhe për energjinë elektrike do të kryejmë për objektet e kultit.

Prandaj, në parim e përkrahim dhe do të japim kontributin tonë në komision me amendamentet tona si “6+”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetë tjerë nuk ka të paraqitur për diskutim. Tri grupet parlamentare nuk janë në sallë. Deputetët që duhet të jenë në sallë, nuk janë.

Atëherë po vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës, me qëllim që t’i diskutojmë e pastaj nëse ka kuorum i miratojmë.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Zoti ministër, ju s’patë diçka të shtoni lidhur me ligjin paraprak?

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Zhvillimit ekonomik, zotin Stavileci që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

BLERAND STAVILECI: Faleminderit zotëri kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, të nderuar kolegë ministra,

Në vazhdim paraqes para jush Projektligjin për energjinë elektrike, përsëri si pjesë e kësaj pakoje të rëndësishme të ligjeve për energjinë.

Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë rregulla dhe masa për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike për të garantuar furnizim të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësorë me energji elektrike, me çmime reale, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikas të tij.

Ky ligj shtënë përputhshmëri me Direktivën 209/72 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregulloren numër 714/2009 për kushtet për qasjen në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

Edhe kjo nismë sikur të tjerat për rishikimin e legjislacionit të sektorit të energjisë burojnë nga detyrimet ndërkombëtare të shtetit tonë në bazë të Marrëveshjes për themelimin e komunitetit të energjisë përkatësisht të vendimit të Këshillit ministror të komunitetit të energjisë ku përcaktohen detyrimet e palëve kontraktuale të komunitetit të energjisë për harmonizimin e legjislacionit të këtij sektori me pakon 3 të legjislacionit të BE-së për energjinë.

Kërkesat themelore të pakos së tretë të legjislacionit të BE-së janë të lidhura me krijimin e kushteve ligjore dhe infrastrukturore që duhet të krijojnë të gjitha palët kontraktuese të komunitetit në mënyrë që të mundësojnë funksionimin e një tregu të përbashkët të energjisë në regjion që përfshin të gjitha këto palë.

Sipas kërkesave themelore të pakos së tretë operatorët e sistemeve të transmissioinit nuk lejohet të jenë të ndërruar me asnjë formë nga aktivitetet e furnizimit dhe prodhimit dhe për këtë duhet të bëhet certifikimi i tyre nga autoriteti rregullativ i tregut të energjisë, kurse Sekretariati i komunitetit të energjisë do të ketë rol konsultativ para vendimit përfundimtar.

Kriteret për vendosjen e obligimit të shërbimit publik do të jenë shumë më rigorozë dhe të përcaktuara qartësisht dhe edhe këtu do të ketë rol konsultativ Sekretariati i komunitetit të energjisë me qëllim të mosdiskriminimit të ndërmarrjeve që veprojnë brenda tregut të përbashkët rajonal ku përfshihen palët kontraktuese të komunitetit të energjisë, heqja e barrierave të licencimit me parimin e reciprocitetit për ndërmarrjet e licencuara në një palë kontraktuese të komunitetit të energjisë, forcimi i rolit të autoritetit rregullues të sektorit të energjisë, e të tjera.

Edhe një herë, deputetë të nderuar, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, ju ftoj që ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti ministër! Fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, por së pari është kryetari i Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, zoti Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër,

Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë në parim këtë ligj dhe ka konstatuar se ky ligj në mënyrë më të mirë dhe më të qartë përkufizon rolin e aktorëve të ndryshëm në këtë sektor, duke i përafshirë të gjitha kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të aktorëve të ndryshëm me kërkesat e komunitetit evropian të energjisë dhe megjithëkëtë siguron një konkurrencë fer dhe në dobi të konsumatorëve në tregun e energjisë elektrike.

Në shqyrtimet mëtejme, edhe në leximin e dytë, vëmendje e posaçme është kërkuar që t'i kushtohet operatorit të tregut, sidomos kompetencave të tij dhe mënyrën e funksionimit të tyre, në mënyrë që të mos dyfishohen funksionet e ndryshme dhe të racionalizohet numri i organeve të pavarura në Kosovë.

Prandaj, i ftoj deputetët që ta aprovojnë në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa! Fjalën e kanë grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Besim Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit zoti nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka trajtuar me kujdes projektligjin për energjinë elektrike dhe meqenëse i plotëson të gjitha nevojat respektivisht edhe standardet të cilat kërkohen në bazë të Traktatit të energjisë, ne i ftojmë deputetët për ta aprovuar sot në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka zoti Grainca.

BLERIM GRAINCA: Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin dhe meqenëse i sqaron dhe rregullon shumë gjëra për të cilat edhe jemi angazhuar, ne i ftojmë të gjithë deputetët ta votojnë në parim këtë projektligj.

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të Listës serbe, zoti Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala potpredsedniče, Poslanička grupa Srpske liste u načelu podržava Nacrt zakona o električnoj energiji jer ovaj Nacrt zakona u suštini utvrđuje pravila i mere funkcionisanja elektroenergetskog sistema kako bi se obezbedilo sigurno, pouzdano, redovno i kvalitetno snabdevanje električnom energijom sa realnim cenama, uzimajući u obzir očuvanje životne sredine.

Takoder Zakon o električnoj energiji jasno je definisan i u skladu je sa zakonima Evropske elektronske zajednice i u skladu je sa obezbeđivanjem fer konkurencije i u korist je potrošača na tržišnoj energiji. Zakon ovakav kakav jeste treba biti podržan od strane svih parlamentarnih grupa a Srpska lista još jednom ponavljam daje podršku danas prilikom prvog čitanja. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Damka, në emër të “6+”.

FIKRIM DAMKA: Faleminderiti zoti kryesues!
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah në parim Projektligjin për energjinë elektrike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, nuk dëshironi ta merrni fjalën! Deputetë nuk ka të paraqitur për fjalë. Edhe këtë pikë e lëmë për votim më vonë.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për emergjencë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e zhvillimit ekonomik, zotin Stavileci që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Të nderuar deputetë,
Pra ky është ligji i katërt në kuadër të pakos së ligjeve për energjinë Projektligji për energjinë.

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme nëpërmjet të cilave drejtohen veprimtaritë në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të cilësisë të lartë me energji për të krijuar kushte për një treg të hapur, funksional, transparent dhe konkurrues, duke promovuar shfrytëzimin më eficient të energjisë, rritjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe koogjenerimi, mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet e energjisë dhe veprimet me të cilat krijohen dhe në bazë të cilave zbatohet politika e energjisë dhe planifikimi i sektorit të energjisë.

Edhe në këtë rast, Kosova si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë është ligjërisht e obliguar t'i harmonizojë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të domosdoshme për të qenë në përputhje të plotë me pakon e tretë të ligjeve për energjinë.

Fushëveprimi i këtij ligji përfshin përcaktimin e kornizës rregullative për zhvillimin e politikave dhe strategjive, rolin e aktorëve në zbatimin e tyre për të siguruar furnizim të qëndrueshëm e efikas me energjinë dhe përfshin energjinë elektrike, energjinë termike, gazin natyror dhe energjinë nga burimet e ripërtëritshme ku përcaktohen zhvillimi dhe zbatimi i strategjisë së energjisë përfshirë parashikimin e bilanceve të energjisë, politikat për eficiencën e energjisë, bashkëprodhimin dhe burimin e ripërtëritshme të energjisë, e po ashtu, rolin e qeverisë në nivel qendror, qeverisjes lokale dhe institucioneve tjera dhe i siguron publikut mundësi për pjesëmarrje të gjerë në zhvillimin e strategjisë së energjisë dhe në zbatimin e saj, veprimtaritë për rregullimin e sektorit të energjisë që kryhen nga zyra e Rregullatorit për energji, ngritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë, vendosjen e detyrimeve për shërbim publik ndaj ndërmarrjeve të energjisë, kurdo që kjo është e duhur dhe e nevojshme, masat që mund të merren në rast të emergjencave energjetike, shërbimet universale si dhe rregullat për mbrojtjen e konsumatorit.

Duke marrë parasysh rëndësinë edhe këtij Projektligji, ju ftoj që ta miratoni. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, zotin Muhamet Mustafa që ta japë vlerësimin lidhur me projektligjin e propozuar.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar ministra,
Komisioni e ka trajtuar këtë ligj dhe sikur edhe ligjet tjera brenda kësaj pako i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë në parim.

Ne konsiderojmë se ky ligj e ka një rëndësi të jashtëzakonshme për të siguruar një furnizim të rregullt, stabil, në sasi të cilësitë e nevojshme të energjisë prej më shumë burimeve dhe për të siguruar një konkurrencë dhe çmime të përballueshme për konsumatorët.

Duke qenë se ky ligj përkufizon në mënyrë të qartë edhe rolin e aktorëve të ndryshëm në pajtim me kërkesat e Komunitetit Evropian të Energjisë, Komisioni i sugjeron Kuvendit që ta aprovojë

në parim dhe të shohim nevojat për ndonjë amendamentim lidhur me çështjet që trajton në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa!

Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare si përfaqësues. Zoti Raif Qela e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar projektligjin për energjinë dhe konsideron se duhet në parim të miratohet me kushtin që, në fazën e mëvonshme, nëse ka nevojë të amendamentohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit kryesues!

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj, në bazë të vlerësimit se opsionet e rekomanduara brenda Projektligjit janë ato ndryshime dhe plotësime realisht që i duhen këtij projektligji, në mënyrë që kjo kornizë e rregullativës ligjore të pajtohet me politikat e reja dhe me strategjitë lidhur me investimet në fushën e energjisë apo me parimet për veprimet në sektorë të energjisë që përfshijnë energjinë elektrike, energjinë termike, gazin natyror, burimet e ripërtëritshme dhe në mënyrë të veçantë ka të bëjë me disa shtesa të cilat lidhen direkt me eficiencën brenda kësaj kornize, eficiencën në fushën e energjisë si dhe normave të cilat u cekën edhe këtu e që kanë të bëjnë me pajtim të normave të reja, pra të këtij projektligji që përfshihen apo duhet këto të përfshihen dhe të jenë në pajtim me ato të Bashkësisë Evropiane, prandaj ne e përkrahim he do të marrim pjesë në të gjitha procedurat e mëtejshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Listës serbe, zoti Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

S obzirom da je ovaj nacrt zakona odnosno zakon o energiji u skladu sa zahtevima Evropske energetske zajednice i u skladu sa obezbeđivanjem konkretne konkurencije i koristi potrošača na tržišti energije, Poslanička grupa Srpske liste danas, prilikom prvog čitanja, podržaje Nacrt zakona o energiji a svoj doprinos u modifikovanju ovog zakona daćemo kroz Funkcionalne komisije za Ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zoti Damka e ka fjalën!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” në parim e përkrah Projektligjin për energjinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pika e dhjetë ka qenë Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë. Kryeministri e ka autorizuar ministrin që ta thotë fjalën e tij lidhur me këtë ligj, respektivisht domosdoshmërinë për t'u tërhequr.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë, ministra,

Me autorizim të kryeministrit të Qeverisë, përkatësisht tërheqim nga rendi i ditës pikën e nëntë Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë mendoj që është në rregull tërheqja e ligjit dhe besoj që do ta sjellin prapë në shqyrtim. Është kërkesë e kryeministrit.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për falimentimin

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA HIKMETE BAJRAMI: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Të nderuar qytetarë,

Më lejon që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projektligji, shkurtimisht të paraqes objektivat e këtij projektligji.

Objekti i parë i këtij projektligji është krijimi i bazës së mirëfilltë për fushën e falimentimit dhe joselvencën e shoqërive tregtare, dispozitat për mbrojtjen, likuidimin dhe shpërndarjen e aseteve të debitorit falimentues të kreditorit dhe dispozita për riorganizimin dhe lirimin nga borxhi për shoqëritë tregtare në falimentim.

Në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore në vitin 2016, një ndër pikat më kritike ku Republika e Kosovës nuk ka rangim të mirë është pikërisht falimentimi.

Në pjesën e fundit të raportit të indikatorit i falimentimit Kosova renditet në pikën 163, e në fakt ajo e ka pozitën 63 në tërësi në gjithë raportin.

Me miratimin e këtij projektligji, ne faktikisht do ta zgjidhim çështjen e falimentimit dhe Kosova pritët që të ketë ngritje në raportin e Bankës Botërore. Do ta përmirësonte dukshëm mjedisin e të bërit biznes dhe do të ofronte siguri të madhe për investitorët vendorë dhe të huaj.

Nëpërmjet këtij projektligji përcaktohet inicimi dhe hapja e procedurës së falimentimit ndaj debitorit në falimentim. Pasojat juridike të hapjes dhe përmbylljes së procedurës së falimentimit, riorganizimin e debitorit në vështirësi financiare kur ekziston mundësia e debitorit të vijë në gjendje falimentimi, riorganizimin e debitorit dhe gjithashtu zgjidhjen e gjithë procesit të falimentimit.

Ky projektligj do të zbatohet nga të gjitha shoqëritë tregtare të rregulluara me Ligjin për shoqëri tregtare, ose me ndonjë ligj tjetër pasardhës.

Me këtë projektligj rregullohet edhe falimentimi ndërkombëtar, kur një gjykatë e huaj ose një përfaqësues i huaj i pasurisë falimentuese i kërkon ndihmë gjykatës kompetente në Kosovë në lidhje me një procedurë të huaj falimentuese, ose kërkohet ndihmë nga një shtet i huaj në lidhje me procedurat e falimentimit sipas këtij ligji.

Në fakt, ky është një ligj tepër i rëndësishëm. Ne i kemi kaluar të gjitha procedurat e konsultimit publik me aktorë të brendshëm dhe aktorë të jashtëm. Ka kaluar gjithashtu në Komisionin Parlamentar dhe unë pres që ky ligj gjithashtu të përmirësohet edhe gjatë dy leximeve nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe pres miratimin e tij në lexim të parë në këtë mbledhje të Kuvendit dhe aprovimin e tij në afate sa më të shkurtra, në mënyrë që ne të bëjmë ndryshim sa i përket ambientit të biznesit në Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është te kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim, Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSATAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Komisioni FunkSIONAL e trajtoi këtë projektligj dhe i rekomandoi Kuvendit që ta aprovojë në parim dhe të vazhdojë procedura për leximin e dytë.

Komisioni konsideron se ky është njëri nga ligjet më të rëndësishme për ta kompletuar në reformën ekonomike dhe për ta përmirësuar ambientin e mjedisit.

Po më duket edhe Arbeni e ka fjalën. Vazhdo!

Pra, edhe një herë po e përsëris - ky është një ligj mjaft i rëndësishëm për ta kompletuar dhe përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të thelluar reformat ekonomike.

Prandaj, e përshëndesim ardhjen në procedurë në këtij ligji nga Qeveria dhe ministria përkatëse.

Ne në komision kemi konsideruar se është e nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe kemi kërkuar që bashkërisht në leximin e dytë të bashkëpunojmë për amendamentimin eventual të këtij ligji.

Gjithashtu, është theksuar nevoja që të rishikohen normat që kanë të bëjnë me falimentimin e ndërmarrjeve që ende e kanë statusin e ndërmarrjeve shoqërore dhe janë nën administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Po ashtu, meriton që të diskutohet pragu vleror i detyrimeve të papaguara dhe periudha kohore lidhur me detyrimet e papaguara se kur një biznes duhet të hyjë në procesin e falimentimit.

Ju ftoj që ta votojmë në parim dhe të bashkëpunojmë në përmirësimin e tij gjatë leximit të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ne në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike e kemi trajtuar me vëmendje Ligjin për falimentimin, një ligj ky jashtëzakonisht i rëndësishëm. Siç u tha edhe nga kryetari i komisionit, janë çështje të cilat janë diskutuar në komision. I kemi diskutuar edhe ne në Grup Parlamentar dhe besojmë që me amendamente të cilat do t'i bëhen ndërmjet dy leximeve, ligji do të jetë në harmoni me rregullat dhe me nevojat e tregut të Republikës së Kosovës.

Prandaj, unë i ftoj deputetët që ta miratojnë në parim, ndërsa ndërmjet dy leximeve do të bëjmë amendamentimet e duhura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, nuk është paraqitur askush. Grupi Parlamentar “6+”, zonja Myfera Shinik.

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim!

“6+” Parlamentar Grubu da aynı şekilde bu Yasa Tasarısını görüşmüştür. Birinci okunuşunu kabul etmektedir, ikinci okunuşuna kadar komisyonlarda katkımızı sunacağız. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Nuk ka tjetër të paraqitur. Edhe këtë do ta votojmë pas pushimit të drekës.

12. Projektligji i parë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotin Zharku, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Zharku, e keni fjalën.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për rregullat e komunikacionit rrugor është projektligji i dytë i pakos së ligjeve për sigurinë në komunikacionin rrugor pas Projektligjit për patentëshofer, i cili tanimë është aprovuar nga ju në leximin e parë dhe po shqyrtohet nga Komisioni FunkSIONAL Parlamentar.

Projektligji për rregullat e komunikacionit rrugor është në harmoni të plotë me legjislacionin evropian, me Konventën e Vjenës për rregullat e komunikacionit rrugor, me qëllimin parësor ngritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor.

Në projektligj, përveç tjerash, janë transpozuar edhe direktivat e BE-së për përdorimin e rripit të sigurisë dhe përdorimin e ulësës së veçantë për fëmijë.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë në konsideratë praktikat dhe standardet e vendeve të rajonit lidhur me këtë fushë, posaçërisht shteteve të rajonit të cilat janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Ky projektligj, përveç rritjes së sigurisë rrugore, do të ketë impak pozitiv në mbrojtjen e ambientit, si dhe në zhvillimin normal të komunikacionit.

Më lejoni që shkurt të përmend çështjet me rëndësi që rregullohen me këtë projektligj:

Me qëllim të mbrojtjes së nxënësve parashihet zona e shkollës ku kufizimi i shpejtësisë është 30 kilometra në orë brenda vendbanimit, përkatësisht 50 kilometra në orë jashtë vendbanimit.

Nuk lejohet që makinat e rënda me zinxhir të lëvizin nëpër rrugë me përjashtim në pjesën e rrugës ku kryhen punimet. Kjo bëhet me qëllim të mbrojtjes së rrugëve nga dëmtimet.

Parashihet përdorimi i rripit të sigurisë dhe ulëses së veçantë për fëmijë konform direktivave të BE-së.

Mundësohet aplikimi i sistemit të pikëve negative me këtë projektligj. Me 9 pikë negative brenda dy viteve parashihet shfuqizimi i patentëshoferit.

Ligji ekzistues parash 9 pikë brenda tre vjetëve dhe është i pazbatueshëm, pasi Ligji për kundërvajtje është në kohëzgjatje deri në dy vjet.

Me qëllim të rritjes së disiplinës në komunikacionin rrugor parashihen dënimet me vuajtje burgimi për shofer, të cilët e kalojnë shpejtësinë mbi 50 kilometra në orë, seç është e lejuar.

Kohëzgjatja e burgut është deri në dy muaj, me të holla, si dhe me pikë negative.

I njëjti dënim me burg parashihet edhe për personin i cili e drejton automjetin pa patentëshofer dhe nuk i lejohet t'i nënshtrohet provimit pa kaluar dy vjet prej marrjes së vendimit të prerë.

Me qëllim të mbrojtjes së ambientit parashihen veprimet e detyrueshme me automjet që duhet t'u përmbahet çdo shofer.

Me qëllim të rritjes së sigurisë rrugore parashihet kontrolli teknik mobil për të gjitha automjetet që lëvizin nëpër rrugë. Kjo do t'i mënjanojë të gjitha të metat që kanë të bëjnë me kontrollimin teknik të automjeteve.

Parashihen dënime më të ashpra për kompanitë kontraktuese me ministrinë apo komunat, të cilat ofrojnë shërbime në fushën e komunikacionit rrugor, siç janë mirëmbajtja e rrugëve, sinjalizimi, punimet në rrugë e tjera.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky projektligj për rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, ju ftoj që ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni e ka shqyrtuar me vëmendje këtë ligj dhe ka konstatuar se në pakon me Ligjin për patentëshofer siguron një legjislacion shumë modern dhe e ka përkrahur. Natyrisht që ne në leximin e dytë do ta shohim eventualisht ndonjë çështje që duhet të përmirësohet dhe konsiderojmë se ky ligj avancoi sigurinë e qytetarëve në komunikacion dhe është në pajtim me kriteret që kërkohen lidhur me përafrimin e legjislacionit tonë me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane.

Prandaj, ftoj deputetët që ta aprovojnë në leximin e parë.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka zoti Grainca, me kartelë të huaj.

BLERIM GRAINCA: Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar projektligjin dhe në parim e përkrah në lexim të parë, kurse gjatë leximit të dytë do t'i bëjë disa plotësime të vogla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Simiq, në emër të Grupit Parlamentar të Listës serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Zahvaljujem podpredsedniče!

Poslanička grupa Srpske liste u načelu podržava Nacrt zakona o pravilima u drumskom saobraćaju. Ovaj Nacrt zakona omogućava povećanje bezbednosti u drumskom saobraćaju i ispunjava kriterijume koje se zahtevaju zakonodavstvom Evropske zajednice.

S toga treba, biti podržano od strane svih parlamentarnih grupa i Poslanička grupa Srpske liste poziva Funkcionalnu komisiju za Ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju da optimalno kreira Zakon o pravilima u drumskom saobraćaju između prvog i drugog čitanja, kako bi zakon prilikom drugog čitanja imao puno podršku od strane svih poslaničkih grupa. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e dëshiron më fjalën. Atëherë, shkojmë në pushim të drekës. Në orën 14:30 fillon seanca, për të vazhduar me votimin. Ju kisha lutur që kryetarët e grupeve parlamentare t'i thërrasin deputetët, meqenëse kemi votim.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Po i kalojmë pikat 13 dhe 14, derisa të bëhet kuorumi dhe vazhdojmë me pikën e 15-të të rendit të ditës që është,

15. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me ndryshimet e propozuara. Ministri s'qenka këtu.

E ftoj kryetaren e komisionit, nuk qenka as ajo. Luljeta, në emër të grupit apo të komisionit? Në emër të grupit parlamentar, zonja Veselaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

E nderuara ministre e Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave afatmesme për periudhën e ardhshme pesëvjeçare 2016-2020 për zbatimin e MSA-së dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar. Ky dokument si i tillë e rrit përgjegjësinë për institucionet e Republikës së Kosovës, ku duke e ushtruar apo zbatuar suksesshëm këtë dokument, vendi ynë jo vetëm që përgatitet për hapat tjerë në procesin e integritetit, por edhe në ngritjen e standardit për qytetarin e vendit tonë.

Siç e dimë tani, viti i kaluar e shënoi një kthesë të rëndësishme për vendin tonë në procesin e integritetit të Kosovës në BE dhe kjo kthesë lidhet ngushtë me nënshkrimin dhe ratifikimin e MSA-së, si dhe me përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave, që janë procese shumë të rëndësishme për të ardhmen e vendit tonë.

Sa i përket Kuvendit, do të jetë një nga shtyllat kryesore institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti në miratimin e legjislacionit. Por, roli i tij do të jetë edhe më i rëndësishëm në aspektin e monitorimit të zbatimit të MSA-së, të mbikëqyrjes së Ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura, si dhe do të kontribuojë në qëndrueshmërinë e reformave, të cilat do të ndërmerren për të siguruar progres në këtë proces.

Po ashtu, roli i Kuvendit do të jetë edhe në përfaqësimin e Kosovës në iniciativa dhe forume të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare, ku si temë kyçe do të jetë procesi i integritetit dhe zbatimi i MSA-së, në tërësi.

Ne si Kuvend tashmë jemi duke u përgatitur për procesin e zbatimit të MSA-së, ku bashkëpunimi me Parlamentin Evropian dhe me institucionet e tjera të BE-së do të ngrihet në një nivel më të lartë. Kjo nuk do të thotë që Kosova i ka përfunduar përpjekjet e saj për integritet në BE.

Përgjegjësitë dhe detyrat tona tashmë vazhdojnë fuqishëm. Ne duhet të angazohjmë të gjitha kapacitetet tona shoqërore në këtë proces, e sidomos në implementimin e kritereve të nevojshme për integrim në BE.

Sa i përket Komisionit për Integritet Evropian, ne si komision jemi duke e intensifikuar mbikëqyrjen dhe llogaridhënien parlamentare me qëllim të mbikëqyrjes së përbushjes së obligimeve, të cilat kanë dalë në procesin e integritetit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i mbështet rekomandimet, të cilat kanë dalë nga Komisioni i Integritetit Evropian dhe i ftoj të gjithë kolegët deputetë që t'i mbështetin këto rekomandime të Komisionit të Integritetit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Sahatqija e ka fjalën për ta arsyetuar raportin dhe rekomandime si kryetare e Komisionit për Integritet Evropian.

TEUTA SAHATQIJA: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Vitin e kaluar në Kuvendin e Kosovës e kemi ratifikuar MSA-në si kontratën e parë të Kosovës me Bashkimin Evropian. Nga ana e BE-së, MSA-ja është në pritje të përfundimit të procedurave para zyrtarizimit dhe fillimi të zbatimit. Për shumë vite është folur për perspektivën evropiane të Kosovës, por vetëm nëpërmjet MSA-së ky diskurs është përkthyer në hapa konkretë dhe masa për realizimin e kësaj perspektive.

Nëpërmjet MSA-së Kosova synon afrimin e saj me BE-në duke u integruar në rrjedhat politike, ekonomike, procesin e Stabilizim-Asociimit nëpërmjet reformave, kritereve dhe kushtëzimeve, të cilat do të sigurojnë zbatimin e suksesshëm të MSA-së. Për t'i shfrytëzuar optimalisht dispozitat që dalin nga MSA-ja është hartuar PKZMSA, apo Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Ky dokument është miratuar nga Qeveria, është shqyrtuar dhe është votuar në Komisionin e Integritetit Evropian prej nga i është dhënë rekomandimi që të votohet në seancën plenare.

Veprimet që kërkojnë zbatim nga PKZMSA-ja, në fakt janë të rëndësishme për rrugën tonë evropiane, por rezultatet edhe më tepër janë të rëndësishme për ne si qytetarë të Kosovës. Reformat në fushën e drejtësisë të sundimi të ligjit, të politikave për luftimin e korrupsionit duhet ta përmirësojnë jetën e qytetarëve tanë, në rend të parë. Ato do të hapin rrugë për investimet e huaja dhe për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Një pjesë e konsiderueshme e MSA-së në fakt ka të bëjë me ekonomi e tarifa të ndryshme. Reformat e kërkuara në ekonomi krijojnë hapësirë për përgatitje dhe fuqizimin e sektorit privat, ngritjen e cilësisë së produkteve tona për të konkurruar në kushtet e konkurrencës evropiane dhe potencialin që firmat tona të depërtojnë në tregun shumë milionësh me konsumatorët të Bashkimit Evropian.

Tatimet, doganat, arsimi profesional, mjedisi e tjera, në mënyrë taksative adresohen veprimet e nevojshme për konkretizimin e këtyre kërkesave. Pra, nëpërmjet PKZMSA-së do të nisë një reformë gjithëpërfshirëse e sektorëve të ndryshëm nën mbikëqyrjen dhe asistencën nga BE-ja nëpërmjet strukturave ekzistuese dhe atyre të reja, të cilat do të krijohen nga MSA-ja.

Një vëmendje e veçantë u është kushtuar marrëdhënieve me fqinjët në kuadër të stabilizimit të rajonit dhe perspektivës evropiane të saj. MSA-ja paraqet mbikëqyrjen, por edhe shqyrtimin e saj pas periudhave të caktuara. Në nenin 33 parasheh rishqyrtim pas tre vjetëve, KSA-ja apo Këshilli për Stabilizim-Asociim rishikon në baza vjetore MSA-në dhe zbatimin e saj dhe nxjerr rekomandime si dhe mund të marrë vendime, në nenin 126.

Banka Evropiane e investimeve do të marrë pjesë si vëzhguese në punën e KSA-së për çështje që lidhen me të, gjë që tregon edhe përkushtimin për zhvillimin e ekonomisë. Duhet cekur se Kuvendi do të jetë një nga shtyllat kryesore institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti miratimin e legjislacionit dhe përputhshmërisë me ‘acquis communautaire’ të BE-së. Rol kyç në kuadër të tij do të ketë Komisioni për Integritet Evropian, si në aspektin e shtyrjes përpara të agjendës legjislative, ashtu edhe atë të koordinuesit për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga Kuvendi.

Së treti, Kuvendi do të ndikojë edhe në strukturat e Stabilizim-Asociimit në kuadër të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit. Si Komision për Integritet Evropian, në fazat që do të pasojnë do ta fuqizojmë edhe më tej bashkëpunimin me shoqërinë civile, duke tentuar që nëpërmjet analizës së dokumentit dhe zbatimit të tij të ndihmojmë dhe t’i përshpejtojmë proceset integruese të Kosovës.

Zbatimi i kënaqshëm i MSA-së brenda tre vjetëve të para do t’i sjellë Kosovës mundësinë që ta bëjë hapin e parë në rrugën e saj integruese, që është aplikimi për statusin e vendit kandidat të BE-së. Ky program fokusohet në tri aspekte strategjike të aderimit të BE-së, që lidhen me përmbushjen e detyrimeve nga MSA-ja, përafrimin e legjislacionit kombëtar me ‘acquis communautaire’ të BE-së dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar me ‘acquis communautaire’.

Që të tri aspektet kërkojnë përkushtim të shtuar, si ajo e përmbushjes së detyrimeve nga BE0aj, të përcaktuara në MSA, po ashtu edhe të përafrimit të ‘acquis communautaire’ së BE-së.

Parlamenti në PKZMSA zë një kapitull të veçantë, ky kapitull mbulon fushëveprimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës që miraton ligje dhe rezoluta dhe, ndër të tjera, shqyrton dhe miraton marrëveshje ndërkombëtare. Po ashtu, ky kapitull e mbulon edhe aspektin mbikëqyrës të Kuvendit që ka të bëjë me mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe institucioneve tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit, si dhe mbulon rolin e Kuvendit në procesin e integritet evropian.

Pikat tjera të rëndësishme që trajtohen nga ky kapitull përfshijnë reformat kyçe kushtetuese që kërkon aderimin në BE, përbërjen dhe strukturën e Kuvendit, funksionet e përgjithshme të tij, funksionimin e strukturave të Kuvendit bazuar edhe në Rregulloren e punës me fokus dhe çështjet relevante për kërkesat e integritet evropiane, përfshirë ato të MSA-së, funksionin legjislativ të Kuvendit, funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, funksionin zgjedhor të Kuvendit në organet autoritetet e Administratës shtetërore, ku i zgjedh dhe i emëron, apo i shkarkon, siç ishte rasti sot, dhe procedurat e përgjithshme.

Rolin e Kuvendit në procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me ‘acquis communautaire’ e BE-së dhe strukturën përgjegjëse dhe zgjedhjet, legjislacioni, sistemi

zgjedhor, funksionimi dhe ecurinë e proceseve zgjedhore. Komisioni i Integriteteve në këtë plan ka barrë dhe përgjegjësi të shtuara. Theks të veçantë do t'i kushtohet Komisionit Parlamentar për Integritete Evropian, roli i të cilit do të përmirësohet akoma më shumë pasi është organ kyç për monitorimin dhe shtyrjen para të reformave dhe kritereve në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe procesit të liberalizimit të vizave.

Në mënyrë që koordinimi me Parlamentin Evropian nëpërmjet komisionit të përbashkët parlamentar të jetë sa më i fuqishëm, përbërja dhe udhëheqja e këtij komisioni të përbashkët do të duhej të ishte në masë më të madhe nga përbërja e vetë Komisionit të Integriteteve.

Ligji për Kuvendin, i cili pritet të aprovohet së shpejti si masë afatshkurtër e dalë nga PKZMSA-ja do ta definojë rolin e Komisionit të Integriteteve dhe përgjegjësitë e shtuara të tij.

Duke pasur parasysh këto dhe rekomandimin e Komisionit për Integritete ju ftoj që ta votoni Programin Kombëtar të zbatimit të MSA-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e doni fjalën? Zoti Çollaku, ministër i Integriteteve e ka fjalën.

MINISTRI BEKIM ÇOLLAKU: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nuk dua të marr kohë më shumë, kryetarja e Komisionit për Integritete Evropiane e elaboroi në detaje përmbajtjen e Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Të gjithë e dimë që kjo marrëveshje është e një rëndësie të jashtëzakonshme për Republikën e Kosovës dhe është mirë që edhe plani për zbatimin e saj po aprovohet sot në Parlamentin e Republikës së Kosovës, vetëm disa javë përpara se kjo marrëveshje të futet në zbatim. Kështu që fillimi i zbatimit të saj ne do të na gjejë krejtësisht të përgatitur me të gjitha strukturat e vendosura dhe të gatshëm për ta zbatuar ashtu siç e ka precizuar edhe plani që e keni për miratim sot në rend të ditës.

Prandaj, edhe një herë ju bëj thirrje që ta miratojmë këtë plan dhe t'i përvishemi punës për zbatimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Çollaku! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare, në qoftë se dëshirojnë fjalën. Fjalën e ka kërkuar zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

E mora fjalën për t'i mbështetur ato pjesë programi që kanë të bëjnë me rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës për ta përballuar një treg më të hapur dhe një konkurrencë më të madhe për prodhimet dhe shërbimet e vendeve të Bashkësisë Evropiane. Megjithatë, në tekstin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim është lënë hapësirë, që mundëson që ne ta kemi një mbrojtje të lehtë të prodhimeve vendore për periudha të caktuara dhe në kohët kur kemi

çrregullime në treg, apo një konkurrencë jo të barabartë dhe gjithashtu, edhe për një lloj preference në proceset e prokurimit publik.

Mendoj se para të gjitha ministrive që merren me zhvillimin ekonomik dhe kanë të bëjnë me rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë, ato janë një pjesë e konsiderueshme e ministrisë, por dhe e aktorëve tjerë, është e nevojshme që deri në detaje të punojmë shumë në këtë çështje, për arsye se ne në Kosovë kemi një industri të re, e cila po zhvillohet ngadalë dhe me vështirësi për shkak të presionit të madh nga importi si dhe për shkak të problemeve tjera që i kemi. Shpeshherë në Kosovë nuk i shfrytëzojmë aso ato mundësi, të cilat na i lejon ndoshta edhe Marrëveshja për Stabilizim-Asociim, apo rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë, në mënyrë që të stimulojmë, ta quaj ashtu, një lloj riindustrializimi të Kosovës, një riindustrializim modern i cili është parakushti themelor që Kosova të ndërtojë ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, që është parakushti themelor për një progres më të madh për integrimin e Kosovës në Bashkësinë Evropiane.

Pra në qoftë se, ne nuk krijojmë politika dhe mekanizma për ta mbështetur prodhimin vendor dhe industrinë vendore, ne mund të bëjmë ligje të mira, mund të bëjmë gjithçka mirë, por do të ngecim në integrim. Prandaj, është esenciale që të ndryshojmë nga pak qasjen, që të kemi politika aktive industriale, të cilat do të mundësojnë që Kosova të zgjedhë dy probleme që e pengojnë shumë zhvillimin ekonomik të Kosovës e kjo është papunësia dhe deficit i madh tregtar. Për të dyja përgjigja është një lloj industrializimi, që duhet të rritë efektet, po them, nëpërmes politikave aktive industriale për t'i shfrytëzuar gjithë ato hapësira për rritjen e aftësisë konkurruese të prodhuesve tonë dhe njëkohësisht rritjen e eksportit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovane dame i gospodo narodni poslanici,

Poštovani građani,

Nacionalni program za sprovođenje sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju je veoma bitan proces za sve nas i mi ćemo da podržimo svaki napor i inicijativu, koja treba da ubrza proces integracije prema Evropskoj uniji.

Sporazum o stabilizaciji i pridruživanju koji smo prethodne godine ratifikovali u Skupštini omogućava podsticanje i ubrzavanje pristupanja našeg društva u Evropsku Uniju. Naše društvo mora da nastavi u pravcu stvaranja tekuće strategije privrednog razvoja izgradnjom jače privrede i ekonomije.

Poslanička grupa Srpske liste podržava plan za sprovođenje i primenu nacionalnog programa za sprovođenje Sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju i pozivamo sve poslanike da isti plan i usvoje. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit “6+”, zoti Paçaku e ka fjalën.

KUJTIM PAÇAKU: I nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” do të përkrahë të gjitha iniciativat, të cilat dalin nga Komisioni për Integritet Evropian, sepse ka të bëjë me integritetin e shtetit tonë në mekanizmat e Evropës dhe për këtë çdo aksion dhe ide që vjen dhe është frytdhënëse për shtetin e Kosovës ne do ta përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur.

16. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin

Komisioni ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Anëtari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, deputeti Fatmir Rexhepi, ftohet për arsyetimin e raportit me rekomandime.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Komisioni Funkcional dhe grup i punës pranë këtij komisioni, duke vlerësuar rëndësinë e fushës së standardizimit në vendin tonë, në të cilën duhet punuar shumë në të gjitha drejtimet me prioritet, mori përsipër edhe mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji në funksionim në praktikë. Duke parë rëndësinë, pra, nga përgatitja, adoptimi, përdorimi dhe zbatimi i standardeve, që kanë një impakt të jashtëzakonshëm në jetën ekonomike të vendit, jo vetëm për prodhuesit por edhe për konsumatorët, për të gjitha produktet, për konkurrencën, qoftë në tregun e brendshëm, qoftë për synime të caktuara për të eksportuar në vendet e jashtme, ku rëndësi të veçantë kanë standardet të cilave duhet përmbajtur në të gjitha fushat.

Ne jemi munduar që të takojmë të gjitha institucionet relevante dhe grupet e interesit me qëllim për të dhënë një pasqyrë sa më të mirë, duke parë rëndësinë e projektligjit në të gjitha takimet, debatet dhe konsultat apo vizitat e ndryshme që i kemi bërë. Prandaj, një pasqyrë lidhur me zbatimin e këtij projektligji e kemi dhënë në përshkrimin në kuadër të materialit që i kemi dhënë Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilat grupi i punës lidhur me zbatimin e ligjit gjen se dispozitat e Ligjit për standardizim në përgjithësi janë të zbatueshme dhe nuk paraqesin vështirësi në zbatim.

Me këtë ligj është përcaktuar që ky ligj nuk zbatohet për standardet e hartuara në fushën e telekomunikacionit, pra të ITU-së. Ministria ka nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme në zbatimin e ligjit. Kemi gjetur po ashtu, që promovimi i standardeve ekzistuese nuk është bërë në masë të mjaftueshme nga Agjencia Kosovare e Standardizimit, kështu që bizneset ende janë të painformuara lidhur me shërbimet që ofron kjo agjenci.

Bashkëpunimi me asociacionet e bizneseve ka munguar në një masë të madhe, sidomos lidhur me interesimin e sektorit privat në përdorimin dhe rëndësinë e standardeve të adoptuara, prandaj edhe numri i bizneseve që përdorin këto standarde në vendin tonë është shumë i vogël. Agjencia para vetes ka pasur diku mbi 16 000 standarde internacionale ISO dhe deri më tani ka adoptuar dhe publikuar gjithsej 8 400 standarde si standarde nacionale të Kosovës, nga të cilat rreth 850 janë marrë në përdorim, që flet për një numër tepër të vogël të bizneseve të interesuara që t'i shfrytëzojnë këto standarde të nacionalizuara.

Në këtë rast po ashtu, kemi parë që agjencia nuk ka përcaktuar prioritetet për disa standarde për t'i adaptuar, ose ka pasur pengesa sepse nuk ka qenë edhe anëtare e ndonjë organizate evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit. Kompetencat për vlerësimin e konformitetit të standardeve janë të paqarta, pasi që nuk mbikëqyrret aplikimi i standardit për produktin për të cilin është marrë standardi. Debati ka rezultuar me ankesa të konsumatorëve dhe të bizneseve në punën e inspektoratit të tregut, në mbikëqyrjen e tregut, kontrollimin e kualitetit të produkteve dhe mallrave të importuara apo të prodhimeve vendore, si dhe përdorimin e tyre sipas standardeve. Bashkëpunimi ndërmjet organeve përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për standardizim nuk është në masën e duhur, prandaj edhe kjo është një vërejtje nga ana e komisionit.

Ne kemi përgatitur pesë rekomandime për Kuvendin, të cilat unë nuk do t'i lexoj për hir të kohës, por edhe nuk po e shoh të arsyeshme, sepse çdo deputet ka pasur mundësi t'i lexojë këto rekomandime. Janë pesë, të cilat kanë të bëjnë me atë se cilat ndryshime duhet bërë në to. Përpjekja që duhet pra, që në fushën e telekomunikacionit të përfshihet në ndryshimin e projektligjit, që Qeveria të bëjë më tepër përpjekje ndihmese, që agjencia të bëhet pjesë e agjencive ndërkombëtare të standardizimit, do të thotë agjencive ndërkombëtare, që Ministria e Tregtisë të rrisë promovimin dhe mundësinë e takimeve me biznesin në të gjitha regjionet, që standardet e adaptuara nacionale të hyjnë në përdorim, t'u jepen bizneseve, të gjejnë ata interesin dhe normalisht, ndihmojnë shumë në prodhimin e këtyre produkteve, gjetjen dhe përdorimin e këtyre standardeve që më lehtë dalin në tregun ndërkombëtar.

Po ashtu, të përcaktojë prioritetet se cilat standarde duhet t'i adaptojmë, si dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të shohë mundësinë e riorganizimit, të bëjë ndryshime në sektorin e akreditimit.

Kemi menduar se për të certifikuar kompanitë, të cilat ofrojnë shërbime të inspektimit dhe pajisje me certifikatë konformiteti për bizneset kosovare, që pretendojnë të ofrojnë shërbime në pajtim me standardet ISO është një punë që e pret ministrinë dhe e cila do të kishte një ndikim shumë të madh në këtë fushë, një përmirësim të dukshëm që duhet të bëhet dhe duhet të kryhet nga ana e ministrisë.

Këto ishin disa nga rekomandimet, prandaj ne i propozojmë Kuvendit që t'i aprovojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Vazhdojmë me pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

17. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Para se të hyjmë në këtë pikë të rendit të ditës edhe një herë lus kryetarët e grupeve parlamentare, që t'i thërrasin deputetët sepse tani është "topi" në dorën tonë dhe duhet ta bëjmë kuorumin në Parlament.

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2016 ka kërkuar nga grupet parlamentare, që deri në seancën plenare të 10 marsit 2016 t'i prezantojnë deputetët për anëtarë të Komisionit

ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Komisioni përbëhet prej 9 anëtarësh.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës për kryetare të komisionit ka propozuar deputeten Selville Halimi, kurse për anëtare deputeten Xhevahire Izmaqi.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar dy deputetë për anëtarë të komisionit: Alma Lama dhe Doruntinë Maloku-Kastrati.

Grupet tjera parlamentare nuk kanë paraqitur dhe i ftoj që t'i paraqesin. Grupi Parlamentar "Vetëvendosje" nuk merr pjesë në seancë dhe s'ka se si ta paraqesë. Grup Parlamentar i AAK-së nuk është në seancë dhe nuk ka si ta paraqesë. Grupi Parlamentar Lista Serbe, e ftoj që ta paraqesë propozimin e një deputeti për anëtar të komisionit. Zoti Slavko Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala podpredsednice!

Poslanička grupe Srpske liste za člana ad hoc komisije predlaže našeg cenjenog i poštovanog kolegu, gospodina Nenada Rašića.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nenad Rashić është i propozuar nga Lista Serbe. Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar "6+", që të propozojë një deputet për zëvendëskryetar të dytë të komisionit. Fjalën e ka zonja Shinić.

MUFERA SHINIĆ: Grupi Parlamentar "6+" propozon deputetin Fikrim Damka.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, konstatoj që zoti Damka është përfaqësues i Grupit Parlamentar "6+". Grupi Parlamentar "Nisma" nuk është në Parlament dhe nuk ka se si t'i propozojë.

Atëherë, e bëjmë një votim formal lidhur me propozimet për Komisionin Ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit. A është dikush kundër? Kush është për? Kundër s'ka.

Konstatoj se Kuvendi i emëroi anëtarë e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, përjashtuar ata që s'janë këtu dhe s'i kanë kandidatët.

Ne i presim të gjitha grupet parlamentare që t'i prezantojnë, dhe edhe pa praninë e tyre mund t'i propozojnë kandidatët.

18. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2016 ka kërkuar nga grupet parlamentare që të propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie.

Grupi Parlamentar i PDK-së, për kryetar të Komisionit e ka propozuar deputeten Xhevahire Izmaku, kurse për anëtar deputetin Zahir Pajaziti.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar 2 deputetë për anëtarë të Komisionit, zotin Naser Osmani dhe zotin Salih Morina.

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është!

Grupi Parlamentar i AAK-së nuk është!

Grupi Parlamentar Lista serbe, kë e ka, zoti Simiq?

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa Srpske liste predlaže Adema Hodžu za člana Komisije. Hvala!

KRYESUESI: Grupi parlamentar Lista serbe propozon deputetin Adem Hoxha. Grupi Parlamentar “6+”? Zonja Shinik!

MUFERA SHINIK: Grupi parlamentar “6+” e propozon deputetin Danush Ademi!

KRYESUESI: Grupi parlamentar “6+” e ka propozuar Danush Ademin. Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është.

Tani e kemi një votim formal. 64 deputetë janë të pranishëm.

Kush është për?

A ka kundër? 1 kundër!

Miratohet.

Atëherë e kam edhe një njoftim:

19. Propozimi i grupeve parlamentare të PDK-së dhe “6+” për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar emërimin e anëtarëve të Komisionit parlamentar, si në vijim:

- Deputeti Avdyli Ymeri është propozuar dhe është anëtar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike.
- Deputeti Bislim Zogaj është propozuar dhe është anëtar i Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian.

Grupi Parlamentar “6+” e ka propozuar deputetin Fikrim Damka për zëvendëskryetar të dytë të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të Duda Balje.

Mendoj që duhet të kemi një votim formal. Janë këto vendime të grupeve parlamentare.

Miratohet! Faleminderit! Të pranishëm i kemi tani 64 deputetë.

Tash i votojmë pikat 7 e tutje të rendit të ditës, që janë shqyrtuar dhe debati për to ka përfunduar.

Tash të pranishëm i kemi 65 deputetë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë

Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani:

Atëherë, 65 vota nëpërmjet elektronikës, 1 pa kartelë - 66 vota për, konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Me 62 vota me elektronikë për, 1 pa kartelë 63, 1 votë kundër, konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për energjinë elektrike.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj se me 64 vota me elektronikë janë për, 1 pa kartelë – 65 vota janë për, 1 kundër, dhe Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për energjinë.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për falimentimin

Edhe kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar dhe diskutuar. Ka ngelur vetëm votimi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Me 66 vota për, 1 pa kartelë - 67 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për falimentimin.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor

Edhe ky projektligj është shqyrtuar më parë. Ka ngelur vetëm votimi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Me 66 vota me elektronikë për, 1 pa kartelë - 67 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës është:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Muhamet Mustafa, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar deputetë,

Unë ju ftoj që të aprovohen amendamentet. Nuk kemi ndonjë sqarim të posaçëm, janë të harmonizuara.

Kjo është iniciativë ligjore në komisione dhe më saktësisht e deputetes Sala Berisha-Shala.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, fillojmë me miratimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

I kemi 62 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime. Me këtë konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për siguri në punë në veprimtarinë minerare.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mjekësinë ligjore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mjekësinë ligjore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesen e Komisionit funksional për legjislacion, zonjën Selvije Halimi që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

Në rregull! Nuk ka nevojë, sepse e ka të kryer.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Ky projektligj i ka gjithsej 9 amendamente.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Kuvendi e miratoi Ligjin për mjekësinë ligjore.

15. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Edhe kjo pikë është shqyrtuar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Me 63 vota për, 1 kundër Kuvendi e miratoi Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, me ndryshimin e propozuar.

16. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin.

Edhe kjo çështje është shqyrtuar, ka mbetur vetëm votimi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj se me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin me rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Meqë për sot nuk kemi më pika të rendit të ditës, më lejoni vetëm të ju njoftoj:

Seanca plenare do të mbahet më 15 mars 2016, në orën 10:00, vetëm me një pikë të rendit të ditës:

1. Rekomandimi i Panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Gjithmonë ta keni parasysh që kjo seancë do të mbahet nëse ky panel e kryen punën e vet më së largu deri të hënën.

Prandaj, ju lus të kemi mirëkuptim! Për këtë ju lajmërojmë, por ne jemi të varur nga ky panel, sepse pika ka të bëjë me liberalizimin e vizave dhe për këtë arsye do ta mbajmë seancën.

Faleminderit dhe mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*